



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 405 Akti

Nr. 404 Vendimi
Tiranë, më 23.6.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Alma Faskaj	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 23.6.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike, çështjen që i përket:

SUBJEKTI TË RIVLERËSIMIT: **Znj. Irena Plaku, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, Dh dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;**
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”;
Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Alma Faskaj, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Plaku, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

3. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Plaku, duke krahasuar “Deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*” me deklaratat e pasurisë në vite dhe dokumentacionin justifikues bankar dhe jo bankar etj., të dorëzuar nga subjekti me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës pranë institucioneve publike. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Plaku, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja konstaton se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë lidhur me të ardhurat e babait të cilat kanë shërbyer për huan e dhënë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016 dhe ka dërguar një raport me shkresën nr. ***, datë 26.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 5.2.2021, të KDZH-së për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Plaku.

5. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

6. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 19.12.2019, të trupit gjykues nr. 4, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 për të tria kriteret, bazuar në pikën 1, të nenit 4, të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; si dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesuesi i trupit gjykues, komisionere Genta Tafa (Bungo). Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

7. Në datën 15.4.2020 subjekti i rivlerësimit u njoftua me përbërjen e trupit gjykues, për të cilin, po në këtë datë, deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e tij.

8. Në datën 4.6.2021, trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Plaku, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes.

9. Në datën 7.7.2021, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të paraqesë pretendime/sqarime shtesë brenda datës 17.6.2021

10. Në datën 9.6.2021, subjekti i rivlerësimit u njoh me materialet e dosjes dhe më 17.6.2021 dërgoi shpjegimet mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

11. Në datën 17.6.2021, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Plaku, në seancën dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike të njoftohet se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 21.6.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

12. Në datën 21.6.2021 u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm.

II. SEANCA DËGJIMORE

13. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Plaku, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.

14. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Plaku, shprehu qëndrimin e saj lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

15. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Plaku, kërkoi konfirmimin në detyrë.

16. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Plaku. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 21.6.2021, për të rifilluar në datën 23.11.2021, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

17. Znj. Irena Plaku ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, duke u përgjigjur dhe duke dërguar dokumentacionin dhe shpjegimet përkatëse sipas kërkesës së Komisionit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

18. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

19. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

19.1 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

19.2 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

19.3 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

19.4 Por, referuar vendimit nr. 2/20171, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

19.5 Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e rivlerësimit kalimtar, *Vetting*”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkrese të administruara nga ILDKPKI-ja, që gjenden në dosjen e subjektit dërguar në Komision; (d) provat shkrese/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; si dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

20. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, u vijua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së subjektit dhe ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

21. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës *Vetting*, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Plaku.

22. Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

23. Procesi i rivlerësimit për komponentin e pasurisë nga Komisioni është bazuar në: (i) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (ii) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratat periodike vjetore të pasurisë për vitet 2010 - 2016 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (iii) hetimin e pasurive të personave të tjerë të lidhur; si dhe (iv) dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ.

24. Subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Plaku, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë *Vetting* (duke përfshirë personat e lidhur), në datën 30.1.2017, në bazë të ligjit nr. 84/2016, fakt ky i konfirmuar nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Pra, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

25. Në deklaratën e pasurisë, shtojca 2, dorëzuar në ILDKPKI në datën 25.1.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshorti F. D., kanë deklaruar:

1. Pasuri të paluajtshme të fituara nga subjekti si pjesë e familjes bujqësore, në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, të ndodhura në fshatin P., Peqin

- a) **Pasuria e paluajtshme e llojit “tokë arë”, me sip. 1296 m²**, me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e regjistruar në emër të shtetasit Y. J. P. . Në bashkëpronësi 1/5 pjesë.
- b) **Pasuria e paluajtshme e llojit “tokë arë + ullishte + truall +banesë”, me sip. 1452 m²**, me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e regjistruar në emër të shtetasit Y. J. P. . Në bashkëpronësi 1/5 pjesë.
- c) **Pasuria e paluajtshme e llojit “tokë ullishte”, me sip. 1898 m²**, me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e regjistruar në emër të shtetasit Y. J. P. . Në bashkëpronësi 1/5 pjesë.
- d) **Pasuria e paluajtshme e llojit “tokë arë”, me sip. 4946 m²**, me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e regjistruar në emër të shtetasit Y. J. P. . Në bashkëpronësi 1/5 pjesë.
- e) **Pasuria e paluajtshme e llojit “tokë arë”, me sip. 2004 m²**, me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e regjistruar në emër të shtetasit Y. J. P. . Në bashkëpronësi 1/5 pjesë.
- f) Në deklaratën *Vetting*, babai i subjektit të rivlerësimit Y. P., pavarësisht se nuk është në rrethin e subjekteve që duhet të deklaronin, ka deklaruar: *“Pasuri e paluajtshme në përdorim, me sipërfaqe 12 dynym, e llojit ‘ullishte’ 200 rrënjë ullinj e paregjistruar në ASHK në emër të Y. P.”*.

1.1 Subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar për herë të parë pasuritë e mësipërme në deklaratën *Vetting* si pasuri të fituara nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”. Pasuritë e lartpërmendura rezultojnë të jenë përfituar me AMTP në emër të babait të subjektit të rivlerësimit Y. P., ku sipas ligjit “Për tokën” i është dhënë tokë bujqësore me sipërfaqe totale 11296 m².

1.2 Subjekti i rivlerësimit, e pyetur¹ për mosdeklarimin në DIPP-të periodike të këtyre pasurive gjatë hetimit, ka deklaruar se: *“Është tërësisht i vërtetë konstatimi juaj... Me qëllim ndreqjen e këtij gabimi që ka ardhur si rezultat i një perceptimi të gabuar të ligjit në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë përpara fillimit të detyrës unë i kam deklaruar këto pasuri në formularin e deklarimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit në janar të vitit 2017 (deklaratën Vetting)... Në momentin e deklarimit të parë fillestar unë në mënyrë të gabuar kam vlerësuar se kam humbur të drejtën e pronësisë mbi tokën e përfituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, ‘Për tokën’, sipas neneve 222 dhe 223 të Kodit Civil, për shkak se nuk kam pasur asnjë kontribut në familjen bujqësore dhe me martesë unë jam shkëputur plotësisht nga familja dhe për këtë arsye nuk e kam deklaruar. Pra, nuk e kam menduar në atë kohë se jam pronarë e kësaj toke...”*.

1.3 Pasuritë e përfituara sipas aktit të marrjes së tokës në pronësi (citurar në vijim si AMTP) në emër të babai të subjektit të rivlerësimit Y.P., janë regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Peqin. Lidhur me pjesën takuese në këto pasuri, subjekti i rivlerësimit deklaron se zotëron 1/5 pjesë takuese si anëtare e familjes bujqësore.

1.4 Gjatë hetimit administrativ për këtë pasuri nga korrespondenca me institucione publike, Komisioni ka administruar dokumentet, si vijon:

- AMTP-në në emër të babait të subjektit të rivlerësimit për sip. 11296 m² arë dhe pemishte në fshatin P. si kryetar i familjes bujqësore;
- certifikatë e përbërjes familjare në datën 1.8.1991.

1.5 Nga përgjigjja e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Peqin², rezulton se pasuritë e mësipërme janë përfituar në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën” dhe në emër të babait të subjektit Y. P. . figurojnë të regjistruara pasuritë, si vijon:

- a) arë, me sip. 1296 m², me nr. pasurie ***;
- b) arë + ullishte + truall + banesë, me sip. 1452m², truall me sip. 300 m² dhe ndërtesë me sip. 115 m², me nr. pasurie ***;

¹Pyetësori nr. 2, përgjigjja nr. 6.

²Shkresë nr. *** prot., datë 30.3.2021, ASHK-ja Peqin.

- c) ullishte, me sip. 1898 m², me nr. pasurie ***;
- d) arë, me sip. 4946 m², me nr. pasurie ***;
- e) arë, me sip. 2004 m², me nr. pasurie ***.

1.6 Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar këto pasuri në DIPP-të periodike në vite. Kjo pasaktësi, e shpjeguar qartë edhe nga subjekti, nuk çmohet nga trupi gjykues si një element që cenon deklarinimin e subjektit për këto pasuri.

1.7 Për pasojë, në analizë të harmonizuar të të gjitha provave të administruara, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në mënyrë të plotë dhe në përputhje me ligjin këto pasuri në deklaratën *Vetting*.

2. Pasuri e paluajtshme e fituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, rreth 18 dynym, e ndodhur në fshatin G., Lushnjë, dhënë në emër të kryefamiljarit R. D. . Pjesa takuese: 1/6, e pandarë.

2.1 Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2010, në të cilën ka deklaruar “tre dynym tokë bujqësore fituar sipas ligjit nr. 7501, me vendndodhje në komunën G., Lushnjë”.

2.2 Gjatë hetimit administrativ të Komisionit, rezultoi se gjyshi i bashkëshortit R. D. ka përfitur tokë bujqësore me sip. 20300 m², në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, sipas AMTP-së nr. *** datë 21.01.1992, në fshatin G., Lushnjë.

2.3 Në bazë të dokumentacionit të administruar nga ZVRPP-ja³ Lushnjë konfirmohet se shtetasi R. D. ka të regjistruara pasuritë e përfituara me AMTP-së nr. ***, datë 21.1.1992, si vijon:

- a) arë + truall, me sip. 875 m², nga të cilat 200 m² truall dhe ndërtesë 112 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, ndodhur në G.;
- b) arë, me sip. 5700 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, ndodhur në G.;
- c) arë, me sip. 13000 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, ndodhur në G.;
- d) arë, me sip. 1600 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, ndodhur në G. .

2.4 Shtetasi R. D. është gjyshi i bashkëshortit të subjektit dhe është mbajtës i AMTP-së nr. ***, datë 21.1.1992, fshati G., me sipërfaqe totale 20300 m². Në bazë të certifikatës së gjendjes familjare të datës 1.8.1991, bashkëshorti është pjesë e familjes bujqësore me banim në fshatin G., Lushnjë, e cila ka në përbërjen e saj 6 anëtarë. Bashkëshorti i subjektit, në cilësinë e anëtarit të familjes bujqësore, ka përfitur 1/6 pjesë takuese.

2.5 Bazuar në shkresën kthim përgjigje të Agjencisë Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Vendore Lushnjë përcillen edhe me kartelat e pasurive, në të cilat rezulton se bashkëshorti i subjektit është bashkëpronar me 3/18 pjesë takuese në pasuritë si vijon:

- pasuria e llojit “arë”, me sip. 5700 m², me nr.***, në fshatin G., Lushnjë;
- pasuria e llojit “arë”, me sip. 13000 m², me nr. ***, në fshatin G., Lushnjë;
- pasuria e llojit “arë” me sip. 1600 m², me nr. ***, në fshatin G., Lushnjë.

2.6 Trupi gjykues, në analizë të harmonizuar të të gjithë provave të administruara, çmon se personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit F. D., ka deklaruar saktë dhe në mënyrë të plotë, në përputhje me ligjin këto pasuri.

3. Kontratë kalim të drejtash nr. *, datë 19.6.2015, ndërmjet palëve “****” sh.p.k., D.Sh., F. D., shoqëria “****” sh.p.k., me objekt “kalimin e të gjitha të drejtave që shoqëria “****” sh.p.k.” mbi apartamentin nr.***, kati i 3-të, godina ***, blloku ***, me sipërfaqe 127.4 m² dhe sipërfaqe ndërtimore 115 m², i ndodhur në rrugën “****”, Tiranë. Vlera e apartamentit: 59,878 euro. Subjekti nuk deklaroi burimin e krijimit të pasurisë në deklaratën *Vetting*.**

³Shkresë nr. ***prot., datë 17.10.2018, aneksi 28, në dosjen e ILDKPKI-së.

3.1 Bashkëshorti i subjektit deklaroi për herë të parë në deklaratën periodike të interesave private të vitit 2015 “kontratë kalim të drejtash, shuma e shlyer 30,000 euro (15,000 euro rrjedhin nga kontrata e huas + 15,000 euro nga kursimet në llogarinë bankare të deklaruar). Gjendja e detyrimit të mbetur 29,878 euro”.

3.2 Subjekti i rivlerësimit deklaroi në deklaratën *Vetting*, në rubrikën e të dhënave konfidenciale, “kontratë për kalimin e të drejtave për apartamentin, i cili ishte në ndërtim dhe pjesërisht i shlyer, në shumën 59,879 euro dhe detyrimi i mbetur pa paguar është në shumën 22,378 euro”.

3.3 Në deklaratën *Vetting* personi i lidhur deklaroi: “Detyrimi që rrjedh nga kontrata e huas nr. ***, datë 16.6.2015, lidhur midis huadhënësit Y. P. dhe huamarrësit F. D., në shumën 15,000 euro, e marrë për pagesën e një kësti për blerje banese, për të cilën është lidhur edhe kontrata për kalim të drejtash. Kjo kontratë është me afat maksimal deri në 15 vjet dhe pa interes”.

3.4 Nga hetimi administrativ i Komisionit rezultoi se bashkëshorti i subjektit F. D. ka lidhur kontratë kalim të drejtash, me objekt “kalimi i të gjitha të drejtave mbi një apartament banimi në sip. 115 m²” kundrejt vlerës 59,878 euro, sipas kontratës kontratën nr. ***, datë 19.6.2015, lidhur midis zotëruesit “****” sh.p.k., përfituesit F. D. dhe “****” sh.p.k. Sipas këtij akti palët kanë rënë dakord për porositjen e një apartamenti në vlerën totale 59,878 euro, sipas kalimit të të drejtave që shoqëria “****” sh.p.k. ka mbi apartamentin nr. ***, kati i 3-të, godina ***, blloku ***, në rrugën “****” Tiranë. Sipërfaqja totale e apartamentit është 127.4 m², nga ku sipërfaqe ndërtimi 115 m².

3.5 Referuar kontratës kalim të drejtash me kontratën nr.***, datë 19.6.2015, palët kanë rënë dakord për mënyrën e pagesës të ndarë në këste.

3.6 Mënyra e pagesës së dakordësuar ndërmjet palëve të parashikuar në kontratë ka qenë si vijon:

- kësti 1 – në datën e nënshkrimit të kontratës vlera 15,000 euro;
- kësti 2 – 15,000 euro brenda tetorit të vitit 2015;
- kësti 3 – 15,000 euro brenda shkurtit të vitit 2016;
- kësti 4 – 14,878 euro brenda tetorit të vitit 2016.

3.7 Subjekti deklaroi gjatë procesit të rivlerësimit se pagesat nuk janë kryer në kohë, sipas parashikimeve të bëra në kontratë, për shkak të ecurisë me vonesë të punimeve nga shoqëritë ndërtuese.

3.8 Rezultoi e provuar se pagesa e kësteve të apartamentit është kryer me transfertë bankare, e cila konfirmohet nga përgjigjja e kthyer nga BKT-ja⁴, gjithashtu konfirmohet edhe nga shoqëria “****” sh.p.k., e cila informon Komisionin lidhur me pagesat e kryera për apartamentin e porositur.

3.9 Nga hetimi rezultoi se vlera e apartamentit 59,878 euro tashmë është shlyer plotësisht, e provuar kjo me pagesat e kryera nga bashkëshorti i subjektit, pas deklaratës *Vetting*.

3.10 Gjatë hetimit rezultoi e provuar se shoqëria “****” sh.p.k., në cilësinë e porositësit, dhe shoqëria “****” sh.p.k., me cilësinë e sipërmarrësit, kanë lidhur kontratën nr. ***, datë 19.6.2015, për prenotimin e një apartamenti nga porositësi dhe marrja përsipër e ndërtimit nga sipërmarrësi. Apartamenti i prenotuar është apartamenti nr. *** (3+1), kati i tretë teknik, godina ***, blloku***, me sipërfaqe ndërtimi 115 m² dhe sipërfaqe të ambienteve të përbashkëta 12.4 m². Vlera e prenotimit është 70,070 euro. Pra, bëhej fjalë për të njëjtin apartament si ai në objektin e kontratës së kalimit të të drejtave.

3.11 Komisioni konstatoi se bashkëshorti i subjektit ka lidhur kontratën për apartamentin pas 4 ditëve nga data e lidhjes së kontratës midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shoqërisë “****” sh.p.k. dhe vlera e tij është më e lartë se ajo e parashikuar në kontratën e kalimit të të drejtave me nr. ***, datë 19.6.2015, prej 59,878 euro.

⁴Shkresë nr. *** prot., datë 16.12.2020.

3.12 Subjekti, lidhur me këtë konstatim, deklaroi gjatë hetimit nga Komisioni⁵ se *diferenca në çmimin e blerjes së këtij apartamenti dhe koha prej 4 ditësh më pas nga një akt tek tjetri nga shoqëria “***” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrëses, rezulton nga marrëdhënia e kleringut që kanë këto dy shoqëri me njëra-tjetrën, ku sipas të cilës vlera e punës së kryer nga sipërmarrësi është konvertuar nga porositësi në sipërfaqe ndërtimi në apartamente.*

3.13 Komisioni hetoi⁶ mbi konfliktin e mundshëm të interesit të subjektit i rivlerësimit, nga ku rezultoi se kjo e fundit nuk ka gjykuar çështje gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë lidhur me procese gjyqësore të shoqërisë së ndërtimit “***” sh.p.k. dhe administratorët e shoqërive sipërmarrëse dhe porositëse.

3.14 Trupi gjykues çmon se nuk ka dyshime dhe rezultoi e provuar se ndryshimi në çmimin e apartamentit është një element që lidhet me marrëdhënien e posaçme që ka shoqëria “***” sh.p.k. me shoqërinë “***” sh.p.k., marrëdhënie kjo “kleringu” e njohur në praktikën juridike të veprimtarisë së subjekteve tregtare në vendin tonë, e provuar⁷ edhe me objektin e veprimtarisë që ky subjekt tregtar kryen, “ndërtime civile dhe ekonomike, projektim dhe kolaudim, sistemim e asfaltim sheshe, ndërtim vepra arti, ndërtime ujësjellësi dhe kanalizime”. Nisur nga fakti se nga ana e personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit është bërë shlyerja e kësaj vlere, e dokumentuar plotësisht me dokumentacion bankar, në mungesë gjithashtu të konfliktit të interesit, nuk ngrihen dyshime lidhur me faktin se kemi një çmim preferencial që lidhet me ushtrimin e funksionit të subjektit të rivlerësimit.

3.15 Lidhur me faktin se shlyerja e kësteve nuk është bërë sipas parashikimit të bërë në kontratën e kalimit të të drejtave, trupi gjykues çmon se duke qenë se likuidimi i kësteve është i provuar plotësisht me dokumentacion bankar, në analizën financiare Komisioni mori në konsideratë si datë shlyerjeje datën e pasqyruar në dokumentacionin bankar dhe deklaratimet e bëra nga subjekti në DIPP-të periodike ndër vite.

3.16 Nga përgjigja e ASHK⁸-së Tiranë nuk rezultoi pasuri e paluajtshme në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj.

3.17 Sa më sipër, trupi gjykues, në analizë të harmonizuar të të gjitha provave të administruara, çmon se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në mënyrë të plotë, në përputhje me ligjin, këtë pasuri, si në DIPP-të ndër vite, ashtu edhe në deklaratën *Vetting*.

3.18 Lidhur me burimin e ligjshëm të pagesës së kësteve të apartamentit dhe aftësinë huadhënëse të babait të subjektit Y.P., për dhënien e huas prej 15,000 euro, Komisioni hetoi dhe vlerësoi, si vijon:

➤ **Kësti i parë: vlera 15,000 euro – data e pagesës 19.6.2015**

3.18.1 Subjekti ka deklaruar se si burim për këtë këst ka shërbyer huaja e marrë nga babai i saj Y. P., sipas kontratës nr***, datë 16.6.2015, datë 16.6.2015, me palë huamarrëse bashkëshortin e subjektit F. D., në shumën 15,000 euro, me afat shlyerjeje 15-vjeçare, pa interes. Shlyerja do të fillojë në vitin 2020, sipas mundësive të huamarrësit.

3.18.2 Në deklaratën *Vetting*, babai i subjektit Y.P. . deklaroi kursime, si më poshtë vijon:

- a) kursime në shumën 800,000 lekë, të padepozituara në bankë, të realizuara nga të ardhurat në bujqësi;
- b) të ardhura nga paga për periudhën janar 2016 – dhjetor 2016 në shumën 2,226,088 lekë; të ardhura të padeklaruara dhe të marra në mënyrë jo formale, në periudhën janar 2009 – dhjetor

⁵Shihni pyetësorin nr. 3, përgjigja nr. 1.

⁶Shkresë nr. ***prot., datë 3.3.2021; shkresë nr. ***prot., datë 7.5.2021.

⁷Shihni informacionin në *website*-in e QKB-së: <https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/>

⁸Shkresë nr. ***prot., datë 18.12.2020.

2009, 50,000 lekë/muaj, janar 2010 – shtator 2015 paguar me pagë mujore 40,000 lekë, shtator 2015 e në vijim paga 35,000 lekë/muaj;

- c) të ardhura nga puna në bujqësi mesatarisht në shumën 600,000 lekë/vit;
- d) të ardhura nga puna e të birit në emigracion, si dhe puna në ndërtim (informale) 3,000 euro/vit ku për 10 vjet janë siguruar 30,000 euro.

3.18.3 Subjekti ka përcjellë me deklaratën *Vetting*, si prova për analizën e burimit të krijimit të vlerës 15,000 euro, dokumentet e mëposhtme⁹:

- a) nxjerrje llogarie të shtetasit z. Y. P. nga “Raiffeisen Bank” dhe BKT;
- b) vërtetim të lëshuar nga shoqëria “***” sh.p.k., për vërtetimin e punësimit të tij pranë kësaj shoqërie për periudhën 9.11.2013 – 30.9.2015, me pagë *neto* + orë shtesë 40,000 lekë/muaj dhe për periudhën 30.9.2015 – 25.3.2016 paga *neto* + orë shtesë 35,000 lekë/muaj;
- c) vërtetim lëshuar nga “***” sh.p.k., për vërtetimin e punësimit të tij pranë kësaj shoqërie nga data 25.3.2016 e në vijim, me pagë mujore *neto* + ore shtesë prej 35,000 lekë/muaj;
- d) vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Agjencia Rajonale Peqin për shtetasen E. P. për derdhjen e kontributeve si e vetëpunësuar në bujqësi prej vitit 1993.

3.18.4 Gjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar se:¹⁰ “...në kontratë bashkëshorti dhe babai im kanë rënë dakord që afati i shlyerjes së kësaj shume do të jetë 15 vjet nga data e nënshkrimit, pra, deri në datën 16.6.2030. Kjo shumë do të fillojë të shlyhet pas 5 viteve nga data e nënshkrimit, pra, në datën 16.6.2020. Shuma e kësteve dhe numri i kësteve është lënë në varësi të mundësive që ne do të kishim...”

3.18.5 Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se në datën 8.11.2019 është bërë pagesa e parë për shlyerjen e huas në vlerën 5,000 euro të derdhur në llogarinë bankare të shtetasit Y. P. . Nga përgjigja e BKT-së¹¹ konfirmohet derdhja *cash* në llogarinë e shtetasit Y. P. . nga bashkëshorti i subjektit F. D. .

3.19 Lidhur me burimin e krijimit të huas në vlerën 15,000 euro nga shtetasi Y. P.

3.19.1 Komisioni, pavarësisht se konstatoi se subjekti kishte deklaruar në deklaratën *Vetting* të ardhurat e babait të saj si një detyrim ligjor, në këndvështrim të nenit 30 dhe nenit 32, pikat 1, 3 dhe 4 të ligjit 84/2016, kreu një hetim të plotë lidhur me aftësinë huadhënëse të babait, si pjesë e familjes prindërore të subjektit të rivlerësimit, me qëllim analizimin e të ardhurave dhe të shpenzimeve të kësaj familjeje. Për këtë arsye, nga Komisioni u konsiderua si anëtar i familjes prindërore, e cila si një e tërë duhet të gjeneronte mundësi kursimi nga burime e ligjshme për dhënien e huas bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Për efekt të analizës financiare përbërja familjare e konsideruar nga Komisioni është e përbërë nga babai, nëna, vëllai, motra dhe subjekti si pjesë e kësaj familjeje deri në vitin 2006, vit në të cilin është larguar me martesë.

Gjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar në Komision¹² se: “*Të ardhurat e babait tim Y. P. kanë qenë nga puna e tij në institucione shtetërore, private të ardhurat nga puna në bujqësi dhe të ardhura nga puna në oficinë që ai ka aktualisht në pronësi dhe për këtë të fundit nuk ka qenë i siguruar si subjekt i vetëpunësuar. Nga viti 1991 - 1993 ai ka emigruar në shtetin grek, ku ka punuar në të zezë si të gjithë emigrantët në atë kohë. Nuk ka asnjë dokument provues për atë kohë. Nga data 23.10.1993 – tetor 1996 ka punuar si mësues, ku sipas vërtetimit të lëshuar nga Bashkia Peqin për periudhën janar 1996 – nëntor 1996, të ardhurat e siguruara janë në shumën 151,313 lekë. Nga muaji tetor i vitit 1996 ai është zgjedhur kryetar i Komunës P., me mandat 4-vjeçar. Të ardhurat e siguruara nga muaji dhjetor 1996 - tetor 2000 janë 938,505 lekë. Prej vitit 2001 - 2014 ka punuar si tornitor në oficinën e tij private që ndodhet në ndërtesën e ndërtuar pa leje prej tij në vitin 2001 në tokën bujqësore nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e regjistruar në emër të Y.P., e legalizuar në vitin 2018 me lejen e legalizimit nr. ***, datë 18.5.2018. Lidhur me të ardhurat nga torno babai im*

⁹Aneks nr. 4/14, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁰Pyetësori standard, përgjigja nr. 19.

¹¹Shkresë nr. *** prot., datë 16.12.2020.

¹²Pyetësori standard, përgjigja nr. 19.

ka shpjeguar se nga viti 2001 - 2007 ka punuar me kohë të plotë dhe të ardhurat mujore i shkonin në varësi të punës nga 60,000 - 70,000 lekë në muaj dhe ndonjëherë edhe 80,000 lekë në muaj... Për këtë ambient ai ka paguar vetëm detyrimin e energjisë elektrike dhe taksat për tokën, duke qenë se e ka pasur të paregjistruar. Babai im ka filluar punën si përgjegjës pike pranë pikës së shitjes së karburantit e njohur si A., që ndodhet në fshatin P. që në vitin 2008, konkretisht në datën 13.8.2008. Gjithashtu, ai ishte përgjegjës edhe për pikën e karburantit që ndodhej në V., Elbasan, ku tek kjo pikë ka punuar nga viti 2008 - 2009... Ai më ka shpjeguar se në atë kohë paguhej me 50,000 lekë në muaj në të dyja pikat shumë të cilën e ka marrë cash, duke qenë se nga subjektet tregtare nuk është deklaruar si punonjës... Ai është deklaruar si punonjës i shoqërisë '***' vetëm në vitin 2009, në korrik 2009, por edhe në këtë rast është deklaruar si punonjës me detyrë shitës karburanti duke i paguar kontribute shoqërore dhe shëndetësore më pagë minimale... Paga mujore që ai ka marrë nga puna si përgjegjës pike karburanti që ndodhet në P. ka qenë 40,000 lekë në muaj, e cila është marrë pjesërisht në dorë dhe pjesërisht në bankë... Gjithashtu, gjatë gjithë kohës ka vijuar të punojë së bashku me nënën edhe në bujqësi, pasi toka ka qenë e mbjellë me kultura të ndryshme. Sipas informacionit të marrë nga babai të ardhurat vjetore nga bujqësia shkonin rreth 600,000 – 700,000 lekë (nga shitja e ullirit, vaj të ullirit, shpendëve gjelave të detit, agrumeve etj.). Nëna ime E. P. ka qenë gjithmonë e punësuar në bujqësi pa asnjë shkëputje dhe për një periudhë ka qenë e punësuar pranë Komunës P. nga viti 1.3.1998 - 31.10.2000.¹³ Sipas vërtetimit të lëshuar nga Komuna P. të ardhurat e siguruara nga puna për këtë periudhë shkojnë 386,246 lekë. Sipas vërtetimit të sigurimeve shoqërore nr. ***, datë 6.1.2020, rezulton se nëna ime prej datës 3.7.2016 figuron në pension pleqërie... Prindërit e mi gjatë gjithë kësaj kohe nuk kanë kryer asnjë investim, pasi banesa në të cilën kanë jetuar dhe vazhdojnë të jetojnë është ndërtuar përpara vitit 1989, duke përdorur të ardhurat e siguruara prej tyre përpara këtij viti”.

3.19.2 Nga hetimi i Komisionit mbi të ardhurat e babait, rezultoi:

a) Komisioni administroi përgjigjen e ardhur nga ISSH-ja¹⁴, e cila informon mbi të ardhurat nga paga të përfituara nga babai i subjektit Y.P., të cilat prej janarit të vitit 2012 deri më 19.6.2015 janë në vlerë totale 863,834 lekë. Nga hetimi i llogarive bankare të shtetasit Y. P. rezultoi se në llogarinë në “Raiffeisen Bank”¹⁵ vlera totale e derdhur nga viti 2012 deri në datën e dhënies së huas është 965,154 lekë, e cila është konsideruar nga Komisioni në analizën financiare. Gjithashtu, edhe nga *statement*-i BKT-së, i përcjellë nga subjekti me deklaratën *Vetting*, rezulton se kanë kaluar vlera në llogarinë e shtetasit Y. P. nga shoqëritë e deklaruara nga subjekti gjatë shpjegimeve, por të cilat nuk përputhen me vlerat e përcjella nga ISSH-ja dhe DTP-ja. Komisioni konstatoi se nga veprimet bankare, paga e hedhur në llogarinë e babait të subjektit është më e lartë se ajo e deklaruar në organet përkatëse.

b) Subjekti ka përcjellë së bashku me shpjegimet¹⁶ vërtetimin e lëshuar nga Bashkia Peqin, ku konfirmohet se janë shlyer të gjitha taksat dhe tarifatat vendore (familjare + tokë bujqësore) për vitet 2006 - 2019. Ndërsa, në lidhje me pagesat e kontributeve bujqësore për periudhën 31.12.1998 – 31.12.2015 ka përcjellë vërtetimin nga Sigurimet Shoqërore Peqin, për nënën e tij E. P. .

3.19.3 Të ardhurat e vëllait të subjektit A. P.

Lidhur me të ardhurat e siguruara nga puna e vëllait A. P. në shtetin grek, subjekti i bashkëlidh deklaratës *Vetting* dokumentacionin e punësimit në këtë shtet, si dhe jep shpjegime lidhur me krijimin e tyre.

a) Subjekti sqaron¹⁷ se: “Vëllai A. P. prej vitit 2000 ka emigruar në shtetin grek si emigrant i paligjshëm fillimisht dhe me pas është pajisur me leje qëndrimi. Në shtetin grek ka punuar deri

¹³Në këtë periudhë babai i subjektit Y.P. ka qenë kryetar i Komunës P. .

¹⁴Shkresë nr. *** prot., datë 19.11.2020.

¹⁵ Nxjerrje llogarie e “Raiffeisen Bank”, aneks nr. 4/14, në dosjen e ILDKPKI-së dhe provat e përcjella me pyetësorin standard.

¹⁶Prova me pyetësorin standard.

¹⁷Pyetësori standard, përgjigjja nr. 19.

në vitin 2009, ku me pas ka emigruar në shtetin italian për disa muaj. Edhe pas kthimit nga Italia ai me periudha kohe të caktuar ka emigruar përsëri në Greqi. Ai më ka shpjeguar se gjatë gjithë kohës së qëndrimit në shtetin grek ka punuar në ndërtim fillimisht si punëtor i thjeshtë vitin e parë e më pas si usta, ndërsa në Itali ka punuar punë të ndryshme... Vëllai ka dërguar 2,000 euro, po edhe më shumë çdo vit në Shqipëri. Gjatë kohës së qëndrimit në Shqipëri në vitin 2010 ai ka punuar në bujqësi, në ndërtim dhe ka siguruar të ardhura 2,000,000 lekë, por nuk ka paguar kontribute të sigurimeve shoqërore dhe si i vetëpunësuar nuk është regjistruar asnjëherë si subjekt tregtar....”.

b) Nga hetimi i Komisionit rezultoi, si vijon:

3.19.4 Subjekti ka përcjellë dokumentacion ligjor për justifikimin e të ardhurave nga puna në emigracion e vëllait për vitet 2002 – 2008, të cilat përfshijnë:

- pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe të ardhurat e deklaruara nga vëllai i subjektit në shtetin grek për vitet 2002 - 2008;
- deklaratat për pagesën e tatimit për të ardhurat personale për vitet 2001 - 2003 dhe 2005;
- lejen e punësimit të lëshuar nga zyra e emigracionit të shtetit italian në qershor të vitit 2009 dhe pajisjen e tij me numrin e kodit fiskal;
- deklaratë noteriale datë 28.8.2018, ku shtetasi B.P.deklaron se shtetasi A. P. e ka ndihmuar për punimet e ndërtimit të banesës së tij në P., për të cilën e ka shpërblyer me 7,000 euro në total për vitet 2008 - 2012;
- përcillet vërtetim nga “AK Invest”, ku vërtetohen se për shtetasin A. P. kanë ardhur dërgesa nga shteti italian, ku ndodhej shtetasi B. P. gjatë periudhës 2014 – 2017, në vlerën totale 1,500 euro;
- kontratë datë 6.4.2010, për blerje automjeti tip “Ford” (kamion), me vlerë 5,000 euro nga shtetasi A. P. .

3.19.5 Të ardhurat e motrës së subjektit A. P.

Subjekti, në lidhje me të ardhurat e motrës A. P. deri në vitin 2015, vit në të cilin është martuar, ka shpjeguar se: *“Në muajin shkurt të vitit 2009 ajo ka filluar punë pranë subjektit tregtar ‘A.V.’ në Tiranë, ku ka kryer detyrën e ekonomistes. Ajo më ka shpjeguar se paga e saj mujore ishte 40,000 lekë dhe në muajt e verës, për shkak të orëve të zgjatura në punë, është paguar me një shtesë 20,000 - 30,000 lekë në muaj, por në organet tatimore është deklaruar me pagë minimale. Pagën e ka marrë një pjesë në dorë dhe një pjesë në bankë. Të ardhurat reale të saj për periudhën shkurt 2010 – maj 2015 janë në total 2,666,976 lekë dhe shuma e derdhur në bankë ka qenë 1,950,016 lekë”.*

Nga hetimi i Komisionit, rezultoi se:

3.19.6 Subjekti ka përcjellë së bashku me shpjegimet vërtetimin për bazën e vlerësuar, hartuar nga ISSH-ja Tiranë për periudhën janar 2012 – dhjetor 2015, për shtetasen A. P. dhe *statement* llogarie në BKT për periudhën nëntor 2010 – dhjetor 2015. Për pasojë, në analizën financiare të Komisionit janë përfshirë të ardhurat nga paga për periudhën janar 2012 – qershor 2015, në vlerën totale 1,205,000 lekë, të cilat konfirmohen nga vërtetimi i ISSH-së.

Të ardhurat e subjektit para detyre

3.19.7 Ndërkohë, në lidhje me kontributin e saj në krijimin e të ardhurave të përbashkëta familjare, subjekti ka shpjeguar se: *“Unë kam filluar punë për herë të parë në vitin 2006 si sekretare gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku kam vijuar të punoj deri në muajin tetor të vitit 2007. Të ardhurat e mia gjatë kësaj kohe kanë qenë në shumën 337,753 lekë. Nga muaji tetor 2007 – muajin qershor 2008 kam punuar si asistente pedagoge pranë Universitetit ***Elbasan. Të ardhurat nga puna ime gjatë kësaj kohe, të llogaritura në bazë të orëve të punës, kanë qenë në shumën 249,832 lekë”.*

3.19.8 Nga hetimi i llogarive bankare në “Raiffeisen Bank”¹⁸ rezultojnë transferta me përshkrim page për subjektin, të cilat për periudhën 2006 – 2009 janë në shumën totale 502,760 lekë. Komisioni i ka konsideruar në analizë këto të ardhura të realizuara para marrjes së detyrës.

Analiza financiare familjes prindërore të subjektit të rivlerësimit

3.19.9 Komisioni, duke konsideruar deklaratimet e subjektit mbi të ardhurat e anëtarëve të familjes prindërore, të përcjella me dokumentacion dhe nga hetimi i kryer, hartoi analizën financiare si më poshtë. Komisioni vlerësoi se analiza financiare është trajtuar prej vitit 2006, vit në të cilin subjekti fiton të ardhura nga puna pas përfundimit të studimeve, por dhe për faktin se për të ardhurat nga bujqësia/blegtoia kushtet dhe detyrimet janë të konfirmuara nga viti 2006¹⁹.

3.19.10 Komisioni nuk ka konsideruar të ardhurat/shpenzimet jetike të vëllait të subjektit deri në vitin 2009, pasi rezultoi se ka qenë emigrant në Greqi/Itali. Në periudhën janar 2010 – qershor 2015 është kthyer në Shqipëri dhe nga Komisioni ka llogaritur të ardhurat dhe shpenzimet si anëtar i familjes prindërore, të cilat u konfirmuan nga dokumentacioni i përcjellë nga subjekti, të trajtuara më lart.

3.19.11 Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga bujqësia dhe blegtoia e familjes prindërore të subjektit, për arsye se nuk u arrit të provohej gjatë hetimit, me dokumentacion nga institucionet vendore dhe rajonale, e ardhura *neto* e realizuar për veprimtarinë bujqësore dhe blegtorale që ushtron familja bujqësore.

3.19.12 Gjithashtu, nisur nga fakti se familja bujqësore e prindërve të subjektit të rivlerësimit jeton në zonë rurale (fshati P., Peqin), shpenzimeve jetike u është zbritur zëri i grupit “ushqime dhe pije joalkoolike”, referuar anketës²⁰ së buxhetit të familjes.

TË ARDHURA	2006-19.6.2015
Të ardhurat nga bujqësia dhe blegtoia e prindërve	
Të ardhura nga paga në pikat e karburantit të babait të subjektit	478 037 Lekë
Të ardhurat nga paga e motrës A. P.	1 205 000 Lekë
Të ardhurat nga vëllai nga emigracioni A. P.	558 223 Lekë
Të ardhura të subjektit para fillimit të detyrës	502 760 Lekë
Te ardhura nga shperblimi sipas deklarates noteriale	558 880 Lekë
Shpenzime per blerjen e automjetit nga vëllai A. P.	- Lekë
Shpenzimet jetike	2 101 403 Lekë
Rezultati financiar	1 479 224 Lekë

3.19.13 Komisioni konstatoi se huadhënësi Y.P. nuk ka pasur mundësi të japë hua në vlerën 15,000 euro deri në qershor të vitit 2015, pasi mund të krijonte vlerën 1,479,224 lekë ose 10,746 euro²¹, duke rezultuar me mungesë të ardhurash të ligjshme në vlerën 4,254 euro dhe për të cilën i kaloi barrën e provës subjektit.

3.19.14 Pas dërgimi të barrës së provës, subjekti parashtrroi dhe depozitoi dokumentacionin provues, si vijon:

Për të ardhurat e babait të saj, subjekti depozitoi:

¹⁸Shkresë nr. *** prot., datë 2.12.2021.

¹⁹Nëna e subjektit rezultoi se ka paguar kontribute te sigurimeve si e vetëpunësuar nga bujqësia prej vitit 1998; pronësia mbi tokën është fituar nga viti 1991, ndërsa konfirmimi për pagesën e taksave mbi tokën rezultoi nga viti 2006 e në vazhdim.

²⁰ <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-familjes/#tab3>

²¹ Kursi i këmbimit mesatar, Banka e Shqipërisë, euro/lekë=137.65.

https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/

- a) fotokopje të librezës së punës dhe sigurimeve shoqërore të babait të saj, nga e cila rezultoi se ka qenë në marrëdhënie pune prej korrikut të vitit 2009 pranë subjekteve tregtare “***” sh.p.k., “***”, “F.” etj.;
- b) vërtetim nr. *** prot., datë 10.6.2021, nga ISSH-ja, Drejtoria Rajonale Elbasan, nga ku rezulton se nëna e subjektit përfiton pension pleqërie prej korrikut të vitit 2016 dhe babai i saj prej prillit të vitit 2020. Ky informacion nuk është përfshirë në analizën e viteve 2006 - 2015 të kryer nga Komisioni, pasi pasqyron të ardhura të përfituara pas kësaj periudhe;
- c) vërtetim nr.***prot., datë 16.6.2021, dhe vërtetim nr. ***prot., datë 16.6.2021, nga ISSH, drejtoria e arkivit, e cila informon se prej korrikut të vitit 2009 deri në dhjetor të vitit 2011 babai i saj përfiton pagën minimale të periudhës.

3.19.15 Trupi gjykues çmoi se pas dërgimit të parashtrimeve dhe provave nga subjekti i rivlerësimit, në analizë financiare është përfshirë edhe vlera shtesë prej 561,547 lekësh, si e ardhur e babait të subjektit, për të cilat u arrit niveli i provueshmërisë me dokumentacionin e sipërcituar.

Në lidhje me të ardhurat e vëllait të saj, pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit depozitoi në Komision dokumentacionin provues, si më poshtë vijon:

- a) deklaratë noteriale nr. ***, datë 10.4.2021, me deklarues shtetasin K. P., i cili deklaroi se gjatë kohës së qëndrimit në Greqi ka strehuar kushëririn e tij A. P., pa shpenzime;
- b) deklaratë noteriale nr. ***, datë 6.7.2020, në të cilën shtetasi K. P. deklaroi se gjatë periudhës 2008 – 2012, kur është ndërtuar banesa e tij në P., ka autorizuar shtetasin A. P. që së bashku me babanë e tij të kryejnë ndërtime, për të cilën e ka shpërblyer në vlerën 8,000 - 10,000 euro;
- c) vërtetim nr. *** prot., datë 11.6.2021, lëshuar nga Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore Peqin, në të cilin konfirmohet se shtetasi A. P. rezultoi i vetëpunësuar në bujqësi për periudhën 1.1.2010 – 31.12.2015.

3.19.16 Trupi gjykues çmoi se, pas dërgimit të parashtrimeve, të ardhurat e vëllait të fituara gjatë periudhës së emigracionit nuk janë përfshirë në analizën financiare të familjes prindërore të subjektit të rivlerësimit, pasi mungojnë dokumentet justifikuese ligjore për t’i konsideruar të ligjshme, si dhe të ardhurat nga ndërtimi i banesave të të afërmeve të deklaruara nuk janë përfshirë në analizë për shkak të paprovueshmërisë së pagesës së tatimit, në bazë të nenit pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

3.19.17 Në lidhje me të ardhurat e motrës, subjekti i rivlerësimit përcolli në Komision, pas kalimit të barrës së provës, kopje të librezës së kontributeve të sigurimeve shoqërore, nga e cila vërtetohet pagesa e sigurimeve shoqërore prej shkurtit të vitit 2010, por këto të ardhura nuk janë përfshirë në analizën financiare të Komisionit, pasi nuk provohet vlera e të ardhurës së fituar.

3.19.18 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, së bashku me parashtrimet, ka përcjellë provat për të ardhurat nga bujqësia dhe blegtoria e familjes prindërore, si vijon:

- a) vërtetim nr. *** prot., datë 15.6.2021, nga Njësia Administrative P., Bashkia Peqin, ku konfirmohet se shtetasi Y.P. ka në pronësi tokë bujqësore, sipas specifikave të shkresës, me sipërfaqe totale 11296 m²;
- b) vërtetim nr. *** prot., datë 10.5.2021, dhe vërtetim nr. *** prot., datë 13.4.2021, nga Njësia Administrative P., Bashkia Peqin, ku vërtetohet se shtetasi Y. P. është banor i fshatit dhe ka shlyer të gjitha detyrimet vendore për taksën e tokës bujqësore të trajtuar me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”;
- c) vërtetime dhe dokumente të tjera provuese të hartuara nga veterinerë, të cilët deklarojnë se kanë vaksinuar kafshët e familjes prindërore dhe banorë të zonës rurale të cilët kanë blerë produkte prej tyre;
- d) aktekspertimin e kryer në datën 11.5.2021 nga ekspertë agronomë dhe zooteknikë, nga ku rezultoi se për periudhën janar 2006 – qershor 2015 vlerësohen si të ardhura *neto* të përfituara

nga blegtoria dhe bujqësia mbi sipërfaqet e tokave bujqësore të shtetasit Y. P., shuma 10,844,675 lekë.

3.19.19 Gjithashtu, në kuadër të hetimit, Komisioni çmoi në dërgimin e një shkrese Bashkisë Peqin lidhur me të ardhurat e realizuara nga shtetasi Y. P. nga aktiviteti i bujqësisë. Bashkia Peqin²² konfirmon se të ardhurat *neto* të shtetasit Y.P. nga blegtoria dhe bujqësia deri në qershor të vitit 2015 janë në shumën 7,902,754 lekë.

3.19.20 Trupi gjykues çmon se, në analizë të harmonizuar të të gjitha provave të administruara në Komision gjatë hetimit, vlerësoi të marrë në konsideratë të ardhurat nga bujqësia dhe blegtoria, të deklaruara nga subjekti në vlerën 600,000 lekë/vit, për periudhën janar 2006 – qershor 2015, për arsye se:

- i. vërtetohet pagesa e detyrimeve fiskale, tatimet dhe taksa për tokën bujqësore;
- ii. shtetasit e mësipërm kanë tokë bujqësore të përfutur me AMTP, të cilën e kanë në përdorim – veprimtaria dhe jetesa e tyre e përditshme zhvillohet dhe është e lidhur pazgjidhshmërisht me jetesën në zonën rurale, fshatin P., në të cilën kanë edhe tokën bujqësore në pronësi;
- iii. nëna e subjektit ka paguar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe është e vetëdeklaruar si e punësuar në bujqësi prej vitit 1998.

3.19.21 Komisioni, në analizë të provave dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës, në konkludim vëren se shuma totale prej 5,700,000 lekësh, e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, e realizuar për periudhën janar 2006 – qershor 2015 nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral, është më e ulët se vlerat e konstatuara nga përgjigjet e strukturave rajonale²³ prej 7,902,754 lekësh dhe/apo nga inspektimet²⁴ në terren të kryera nga ekspertët me vlerë të ardhure *neto* 10,844,675 lekë.

3.19.22 Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel provueshmërie dhe besueshmërie të mjaftueshme për të konsideruar të ardhura të ligjshme të familjes prindërore, me burim aktivitetin nga bujqësia dhe blegtoria, shumën prej 5,700,000 lekësh të deklaruar prej saj dhe personat e lidhur.

3.19.23 Në vijim, në analizën financiare të familjes prindërore janë zbritur nga niveli standard i shpenzimeve jetike vlerat²⁵ e produkteve të cilat sigurohen dhe prodhohen nga familjet rurale nëpërmjet aktivitetit bujqësor dhe blegtoral të tyre, të tilla si qumështi dhe nënproduktet e tij, vezë, mish fruta, perime, drithëra, etj.

²² Shkresë nr. *** prot., datë 16.6.2021.

²³ Shkresa e Bashkisë Peqin, Njësia Administrative P. .

²⁴ Aktekspertimi i kryer nga ekspertë agronomë dhe zooteknikë në datën 11.5.2021.

²⁵ Janë zbritur nga niveli standard i shpenzimeve jetike vlera e grupit “ushqime dhe pije jo-alkoolike”.

Për vitet 2006 - 2007: ushqimi (pa përfshirë pijet alkoolike) mbetet një element i rëndësishëm në buxhetin familjar duke zënë 47.6% të tij. Në këtë grup, peshën më të madhe e zë shpenzimi për “mish dhe nënprodukte” që përbën rreth 22.5 % të buxhetit brenda grupit. Produktet që vijnë më pas për nga vlera e shpenzuar janë “qumështi, vezët dhe nënproduktet e tij” (me një peshë prej 16.1%), si dhe “bukë dhe drithëra” (15.5 %). Nëngrupet që vijnë më pas janë perimet që zënë 14 % të grupit kryesor dhe frutat që zënë 8.8%. Për vitet 2008 - 2011 është zbritur përqindja e grupit “për ushqim”, me vlerë 57.9 % sipas anketës së matjes së nivelit të jetesës. Për vitet 2012 - 2013 është zbritur përqindja e grupit “për ushqim” me vlerë 58.4 % sipas anketës së matjes së nivelit të jetesës. Për vitin 2014 ky grup mbetet një element i rëndësishëm në buxhetin familjar, duke zënë 44.3 % të tij në vitin 2014. Në këtë grup mund të veçohen tre nëngrupe që zënë peshën më të madhe në shpenzimet për ushqim: “mish dhe nënprodukte”, “bukë dhe drithëra”, “qumësht me nënproduktet e tij dhe vezë”, që përbëjnë secili rreth 20 % të buxhetit brenda grupit përkatës. Nëngrupet që vijnë më pas janë “perimet”, që zënë 14.3 % të grupit kryesor dhe “frutat” që zënë 7,6 % të tij. Për vitin 2015: grupi “ushqime dhe pije jo-alkoolike” mbetet elementi më i rëndësishëm në buxhetin familjar duke zënë 48.7 % të tij. Tre nëngrupet që në vitin 2015, ashtu si dhe në vitet e kaluara, zënë peshën më të madhe në shpenzimet për ushqim janë: “qumësht me nënproduktet e tij dhe vezë” (18.8 % të buxhetit brenda grupit), “mish dhe nënprodukte” (17.4 % të buxhetit brenda grupit) dhe “bukë dhe drithëra” (17.0 % të buxhetit brenda grupit). Nëngrupet që vijnë më pas janë “perimet”, që zënë 13.3 % të grupit dhe “frutat” që zënë 7.9 % të tij.

Burimi: INSTAT, Anketa e Buxhetit të Familjes http://www.instat.gov.al/media/2068/abf_2014_final_16_09_2015_18_34.pdf;
http://www.instat.gov.al/media/2069/abf_2015.pdf;
http://www.instat.gov.al/media/2067/buxheti_i_familjes.pdf;
http://www.instat.gov.al/media/2063/anketa_e_matjes_se_nivelit_te_jeteses_2008.pdf;
http://www.instat.gov.al/media/2065/anketa_e_matjes_se_nivelit_te_jeteses_2012_rishikuar.pdf

TË ARDHURA	Periudha 2006 – 19.6.2015
Të ardhurat nga bujqësia dhe blegtoria e prindërve	5,700,000 lekë
Të ardhura nga paga në pikat e karburantit të babait të subjektit	1,039,584 lekë
Të ardhurat nga paga e motrës A. P.	1,205,000 lekë
Të ardhura të subjektit para fillimit të detyrës	502,760 lekë
Shpenzime për blerjen e automjetit nga vëllai A.P.	694,050 lekë
Shpenzimet jetike	2,948,130 lekë
Rezultati financiar	4,805,164 lekë

3.19.24 Nga analiza financiare për periudhën 2006 – qershor 2015 mbi prindërit dhe familjen prindërore të subjektit, rezulton se ata kanë pasur mundësi të krijojnë të ardhura nga burime të ligjshme në vlerën 4,805,164 lekë ose²⁶ 34,908 euro.

3.19.25 Trupi gjykues çmon se subjekti provoi bindshëm, në vështirim të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, burimin e ligjshëm të të ardhurave të personit të lidhur, për dhënien e huas prej 15,000 euro.

➤ **Kësti i dytë: vlera 15,000 euro – data e pagesës 30.10.2015**

3.20 Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2015 se si burim për këtë pagesë janë përdorur kursimet në llogarinë bankare të deklaruar “kursime nga pagat të depozituar në ‘Union Bank’ në shumën 1,100,000 lekë dhe interesin e saj”.

3.21 Referuar korrespondencës së Komisionit me “Union Bank”²⁷ rezulton se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e ardhur. Në këtë bankë rezulton të jetë hapur depozitë në datën 13.9.2013, e cila është krijuar nga një depozitim *cash* i bërë nga subjekti në vlerën 750,000 lekë (datë 13.9.2013) dhe nga gjendja në llogarinë bankare të krijuar nga të ardhurat e saj nga pagat. Kjo depozitë ka pasur afat 2-vjeçar dhe është mbyllur në datën 13.10.2015 dhe shuma e saj, së bashku me gjendjen në llogari nga pagat dhe interesin e depozitës (101,236 lekë), të gjitha në shumën totale prej 2,000,000 lekësh, janë tërhequr nga subjekti në datën 30.10.2015.

3.21.1 Komisioni konstatoi se subjekti nuk kishte deklaruar në DIPP-në e vitit 2013 burimin e krijimit të vlerës 750,000 lekë të derdhur *cash*.

3.21.2 Subjekti i rivlerësimit, e pyetur nga Komisioni²⁸, ka deklaruar se: “Kjo shumë ka rrjedhur nga kursimet e mia dhe të bashkëshortit gjatë viteve të mëparshme, konkretisht që nga viti 2010 deri në vitin 2013 (kohë kur është çelur depozita), të cilat i kemi pasur *cash* në banesë, të tërhequra përgjatë viteve të sipërpërmendura nga llogaritë bankare të pagave”.

3.21.3 Në DIPP-në e vitit 2012 subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në banesë prej 600,000 lekësh dhe në fund të vitit 2013 ka deklaruar gjendje *cash* në banesë prej 100,000 lekësh.

3.21.4 Referuar deklarimeve dhe shpjegimeve të subjektit gjatë hetimit është hartuar analiza financiare në lidhje me burimin e krijimit, si më poshtë vijon:

<i>Analiza financiare</i>	<i>Viti 2013</i>
Të ardhurat nga paga e subjektit	726 610 lekë
Të ardhurat nga paga të bashkëshortit	608 401 lekë
Pagesë qiraje	144 000 lekë
Shpenzime arsimit për fëmijët	72 067 lekë
Shtim i likuiditeteve në bankë	642 556 lekë

²⁶Kursi i këmbimit mesatar Banka e Shqipërisë, Euro/Lek= 137.65;

https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/

²⁷Shkresë nr*** prot., datë 2.12.2020.

²⁸Shihni pyetësorin nr. 3, përgjigjja nr. 2.

Shpenzime jetese	564 096 lekë
Shpenzime udhëtimi	4 203 Lekë
Rezultati financiar	- 91 911 lekë

3.21.5 Në analizë financiare sa më sipër, subjektit i kaloi barra e provës, pasi rezultoi në pamundësi financiare në shumën 91,911 lekë për krijimin e shumës 750,000 lekë, të derdhur *cash* në fund të vitit 2013. Për pasojë, kjo diferencë ekziston dhe në pamundësinë e tij në shumën 91,911 lekë për pagimin e këstit të dytë të apartamentit.

- **Kësti i tretë: vlera 5,000 euro – data e pagesës 25.2.2016 dhe kësti i katërt në vlerën 2,500 euro – data e pagesës 14.6.2016**

3.22 Subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2016 se pagesa prej 7,500 euro rrjedh nga kursimet nga pagat e përbashkëta dhe nga kursimet e mbetura nga viti 2015.

3.23 Nga hetimi i deklarimeve periodike vjetore rezulton se subjekti nuk ka deklaruar gjendje kursimesh në fund të vitit 2015. Ndërsa, nga verifikimi i llogarisë bankare të subjektit në “Union Bank” rezulton se në datën 24.2.2016 subjekti ka tërhequr shumën 700,000 lekë, të krijuar nga gjendja e të ardhurave nga pagat e saj.

3.23.1 Në vijim, Komisioni ka hartuar analizën financiare deri në datën e kryerjes së pagesave, si vijon:

<i>Analiza financiare</i>	<i>01.01.2016-14.06.2016</i>
Të ardhurat nga paga e subjektit	439 780 Lekë
Të ardhurat nga paga të bashkëshortit	286 579 Lekë
Pakësime të likuiditeteve në bankë	- 458 153 Lekë
Pagesë qeraje	60 000 Lekë
Shpenzime arsimit për fëmijët	60 680 Lekë
Kësti i tretë dhe katërt	1 014 525 Lekë
Shpenzime jetese	391 820 Lekë
Rezultati financiar	- 342 513 Lekë

3.23.2 Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, pasi rezultoi me pamjaftueshmëri financiare për të kryer pagesat e këstit të dytë në vlerën 91,991 lekë, si dhe këstit të tretë dhe katërt në vlerën 342,513 lekë, me të ardhura të ligjshme.

3.23.3 Në parashtrimet e saj, subjekti ngre pretendime mbi analizën financiare të vitit 2013, duke kërkuar uljen e shpenzimeve jetike, pasi prindërit e saj dhe të bashkëshortit, të cilët jetojnë në zona rurale, kanë kontribuar në uljen e shpenzimeve për ushqim²⁹ dhe se këto shpenzime kanë qenë më të ulëta në qytetin e Korçës ku ajo jetonte. Subjekti ka kërkuar edhe uljen e shpenzimeve për dy udhëtime të kryera nga bashkëshorti në Maqedoninë e Veriut në vitin 2013, të cilat ishin vajtje-ardhje, me disa orë qëndrimi dhe në një prej tyre rezultonte pasagjer në automjetin e shtetasit S. B.

3.23.4 Komisioni, bazuar edhe në praktikën e tij, nuk mund të pranonte parashtrimet/kërkesat e subjektit të rivlerësimit për uljen e shpenzimeve jetike. Ndërsa për shpenzimet e udhëtimit, vërejtje se nga përgjigjja e Policisë së Shtetit me të dhënat e sistemit *TIMS* rezultoi se përputhej me pretendimet e subjektit. Për vitin 2013 analiza financiare amendohet, si vijon:

²⁹ Përcjell deklaratën noteriale nr. ***, datë 25.5.2021, dhe deklaratën noteriale nr.***, datë 11.6.2021.

<i>Analiza financiare</i>	<i>Viti 2013</i>
Të ardhurat nga paga e subjektit	726 610 lekë
Të ardhurat nga paga të bashkëshortit	608 401 lekë
Pagesë qiraje	144 000 lekë
Shpenzime arsimi për fëmijët	72 067 lekë
Shtim i likuiditeteve në bankë	642 556 lekë
Shpenzime jetese	564 096 lekë
Shpenzime udhëtimi	0 lekë
Rezultati financiar	- 87 708 lekë

3.23.5 Komisioni çmoi se shpjegimet e subjektit ishin bindëse dhe të mbështetura në prova, duke reflektuar qëndrimin e saj në analizën financiare, nga ku rezultoi se për vitin 2013 ka pamundësi financiare në vlerën 87,708 lekë dhe për vitin 2016 vazhdon të ketë pamundësi në vlerën 342,513 lekë.

3.23.6 Trupi gjykues çmon se balanca negative e konstatuar do të vlerësohet në tërësinë e konstatimeve gjatë procesit të rivlerësimit.

4. Automjet tip “Ford Fokus”, me targa *, vit prodhimi 2001, e fituar me kontratën e shitjes nr. ***, datë 25.6.2012, në vlerën 300,000 lekë.** Subjekti nuk deklaroi burimin e krijimit në deklaratën *Vetting*.

4.1 Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2012 blerjen e një automjeti për përdorim personal, tip “Ford Fokus”, vit prodhimi 2001, me kontratën nr. ***, datë 25.6.2012, në vlerën 300,000 lekë.

4.2 Komisioni ka administruar gjatë hetimit kontratën nr. ***, datë 25.6.2012, ku bashkëshorti i subjektit ka blerë automjetin tip “Ford Fokus”, me targa ***, nga shtetasi V. B. . Ky shtetas, referuar informacionit të përcjellë nga DPSHTRR-ja, rezulton se e ka blerë automjetin në datën 15.4.2012, në shumën 3,000 euro.

4.3 Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit dhe iu drejtuar me shkresë³⁰ edhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila informon se pranë kësaj gjykate shtetasi V. B. nuk rezulton të ketë qenë palë ndërgjyqëse dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka gjykuar çështje me palë këtë shtetas.

4.4 Lidhur me burimin e ligjshëm, subjekti ka deklaruar se është blerë me kursime nga pagat e përbashkëta të saj dhe të bashkëshortit, të deklaruara në deklaratimet periodike.

4.5 Komisioni hartoi analizën financiare për burimin e krijimit të automjetit, duke konsideruar kursimet nga të ardhurat nga paga e vitit 2010 deri në datën e blerjes, 25.6.2012, dhe rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për krijimin e saj, pasi rezultati financiar është me vlerë pozitive në shumën 284,892 lekë.

<i>Analiza financiare</i>	<i>1.1.2012 – 25.6.2012</i>
Të ardhurat nga paga e subjektit	328 975 Lekë
Të ardhurat nga paga të bashkëshortit	307 495 Lekë
Pakësime të likuiditeteve në bankë	(316 591) Lekë
Pagesë qiraje për banesën në P*** me vlerë 12,000 lekë/muaj	60 000 Lekë
Automjet tip “Ford Focus”, blerë në datën 25.6.2012.	300 000 Lekë
Shpenzime jetese	308 169 Lekë
Rezultati financiar	284 892 Lekë

³⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 8.4.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

4.6 Sa më sipër, në analizë të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, shpjegimeve dhe deklarimeve të subjektit gjatë hetimit, si dhe analizës financiare të hartuar, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur mundësi të krijojnë pasurinë e mësipërme me të ardhura të ligjshme.

5. Pasuri të deklaruara në përdorim në deklaratën *Vetting*, në deklaratimet periodike dhe gjatë procesit të rivlerësimit

5.1 Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* pagesë qiraje banese në vlerën 12,000 lekë/muaj, për periudhën 1.3.2012 – 31.12.2016, sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 24.10.2016.

5.2 Subjekti ka deklaruar për herë në deklaratën periodike të interesave private të vitit 2012 marrjen në përdorim të saj dhe pagesë qiraje në vlerën 12,000 lekë, në total për të gjithë vitin në shumën 144,000 lekë.

5.3 Lidhur me këtë pasuri të marrë në përdorim, subjekti ka deklaruar se është shpërngulur në qytetin e Pogradecit, ku së bashku me bashkëshortin kanë vendosur të jetojnë gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Në shkurt të vitit 2012, subjekti ka deklaruar se ka lidhur kontratën e qerasë ndërmjet bashkëshortit dhe shtetasit G.M. me afat 1-vjeçar, kundrejt vlerës 12,000 lekë/muaj. Pagesa e qirasë i është bërë gjithmonë këtij shtetasi dhe *cash*.

5.4 Bashkëshorti i subjektit F.D. dhe shtetasi M. M. kanë nënshkruar deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.10.2016, në të cilën deklarojnë se kanë lidhur kontrate qiraje në datën 1.3.2012, për dhënie me qira të pasurisë apartament banimi, me sip. 103.34 m², me nr. ***, ndodhur në Lagjen nr. 1, Pogradec. Subjekti, gjatë procesit të rivlerësimit, ka shpjeguar se *kontrata ka qenë e ndarë në periudha 1-vjeçare dhe për këtë arsye nuk ka qenë e nevojshme të bëhet me shkresë. Qiraja mujore është në vlerën 12,000 lekë/muaj dhe është paguar deri në datën 24.10.2016.*

5.5 Komisioni, referuar dokumentacionit të bashkëlidhur nga subjekti, ka konstatuar se pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, është në pronësi të shtetasit M. M. .

5.6 Komisioni ka hetuar lidhur me ekzistencën ose jo të konfliktit të interesit, nga ku rezultoi se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë shtetasit M.M. dhe G. M. nuk rezultojnë të kenë qenë palë ndërgjyqëse.

6. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* pagesë qiraje sipas kontratës së datës 1.1.2017, në vlerën 20,000 lekë/muaj, për apartamentin me adresë: rruga “**”, pallati ***, apartamenti nr. ***, Tiranë.**

6.1 Subjekti e ka deklaruar për herë të parë marrjen në përdorim të këtij apartamenti në deklaratën periodike të interesave private të vitit 2017. Në pyetësonin standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar lidhur me adresat e banimit, duke filluar nga janari i vitit 2017, apartament me qira në rrugën “****”, pallati ***, apartamenti nr. ***. Bashkëshorti i subjektit ka lidhur kontratë qiraje (jo noteriale), datë 1.1.2017, me qiradhënë Xh.K. dhe qiramarrës F. D., të apartamentit me sip. 103.5 m², me nr. pasurie ***, z. k****, vol****, f. ***, të ndodhur në rrugën “****”, me afat tremujor, në vlerën 20,000 lekë/muaj.

6.2 Për periudhën përpara emërimit në detyrë lidhur me adresat e banimit dhe marrjes në përdorim të pasurive, subjekti ka deklaruar se në dhjetor të vitit 2008 fillimisht ka jetuar së bashku me bashkëshortin në një garsoniere të ndodhur në rrugën “****”. Më pas ka jetuar në një apartament me qira të ndodhur në Njësinë Bashkiake Nr. 2, rruga “****”, pallati ***, apartamenti nr. ***, Tiranë, ku edhe janë regjistruar si banorë të qytetit të Tiranës. Nga hetimi rezulton se subjekti ka lidhur kontratën e qirasë datë 2.12.2008, me afat 1-vjeçar, kundrejt çmimit 20,000 lekë/muaj.

6.3 Sa më sipër, trupi gjykues çmon se subjekti ka bërë një deklaram të saktë lidhur me të drejtën e përdorimit të këtyre pasurive.

7. Të ardhura nga interesat bankare të depozitës bankare në shumën 1,100,000 lekë, me afat dyvjeçar, të depozituara në datën 13.9.2013, me afat të përfundimit datë 13.10.2015, për 2 vjet, të kaluara në llogarinë rrjedhëse në “Union Bank”. Vlera e interesit është 101,236 lekë.

7.1 Subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike të interesave private të vitit 2013 kursime nga të ardhurat nga pagat e përbashkëta të subjektit dhe të bashkëshortit të depozituara në “Union Bank”, kursime të mbartura nga vitet e mëparshme në shumën 1,100,000 lekë.

7.2 Në analizë të informacionit të përcjellë nga “Union Bank”³¹ në datën 13.9.2013 rezulton të jetë hapur depozitë, e cila është krijuar nga një depozitim *cash* i bërë nga subjekti në vlerën 750,000 lekë (datë 13.9.2013) dhe nga gjendja në llogarinë bankare të krijuar nga të ardhurat e saj nga pagat. Kjo depozitë ka pasur afat 2-vjeçar dhe është mbyllur në datën 13.10.2015 dhe interesat e saj pas mbajtjes së tatimit janë derdhur në llogarinë e subjektit në vlerën 101,236 lekë.

7.3 Nga sa më sipër, duket se deklarimi i subjektit në DIPP-në e vitit 2013 përputhet me deklaratën *Vetting* dhe me përgjigjen e përcjellë nga “Union Bank”.

8. Deklarimi i kursimeve në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratën periodike të interesave private ndër vite

- Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* kursime nga pagat të padepozituara në bankë, në vlerën 150,000 lekë.
- Në deklaratën e pasurisë dhe interesave para fillimit të detyrës (viti 2010), subjekti nuk deklaroi kursime.
- Ndërsa në DIPP-të e viteve 2010 - 2016 subjekti, në lidhje me kursimet, deklaroi si vijon:
 - a) në DIPP-në e vitit 2010 deklaroi *kursime nga të ardhurat nga paga e saj dhe e bashkëshortit, si dhe nga shpërblimet nga paga e bashkëshortit “Garda e Republikës”, në shumën 100,000 lekë cash në banesë;*
 - b) në DIPP-në e vitit 2011 deklaroi *kursime në banesë nga paga e saj dhe e bashkëshortit në shumën 200,000 lekë;*
 - c) në DIPP-në e vitit 2012 deklaroi *kursime nga pagat (e saj dhe e bashkëshortit), të padepozituara në bankë, në shumën 600,000 lekë;*
 - d) në DIPP-në e vitit 2013 deklaroi *kursime nga pagat, të padepozituara në bankë, në shumën 100,000 lekë;*
 - e) në DIPP-të e viteve 2014 dhe 2015 nuk deklaroi kursime të padepozituara në bankë ose të mbajtura në gjendje *cash*;
 - f) në DIPP-në e vitit 2016 deklaroi *kursime nga pagat, të padepozituara në bankë, në shumën 150,000 lekë.*

8.1 Subjekti ka deklaruar gjatë procesit të rivlerësimit se këto janë gjendjet e kursimeve *cash* në banesë për secilin vit. Komisioni i ka konsideruar vlerat e mësipërme si deklarime të gjendjes *cash*/kursimeve nga subjekti. Analiza e burimit të krijimit të këtyre vlerave të kursimeve është përfshirë në analizën financiare të viteve 2010 - 2016, si më poshtë paraqitur.

³¹Shkresë nr. *** prot., datë 2.12.2020.

ANALIZA FINANCIARE

9. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, si dhe në deklaratimet periodike ndër vite, duke përfshirë të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet dhe detyrimet, nga përlogaritja e tyre është vlerësuar dhe është konkluduar mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për çdo vit për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të kursyera me të ardhurat nga burime të ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

10. Pasi janë analizuar dhe vlerësuar nga trupi gjykues edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit, pasi janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat, duke filluar nga viti 2010, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i subjektit në ILDKPKI, deri në vitin 2016, si rezultat i përgjithshëm vjetor dhe përfundimtar ka rezultuar me një bilanc të përgjithshëm në vlerë negative prej 1,354,118 lekësh.

11. Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor në rezultatet financiare të viteve përkatëse, të lidhura kryesisht me shpenzimet e udhëtimeve ditore vajte-ardhje dhe me paraqitjen e dokumentacioneve justifikuese mbi shpenzimet e udhëtimeve të saj ose bashkëshortit pas përcjelljes së rezultateve. Duke u mbështetur mbi të tilla shpjegime u arrit në konkluzionin se rezultati i analizës financiare të subjektit është në vlerën negative totale prej 739,912 lekësh.

12. Në lidhje me problematikat e analizës financiare, trupi gjykues çmon se këto pasaktësi dhe këto mangësi të burimeve financiare – për një total të akumuluar në shumën 739,912 lekë (me bilanc negativ në analizën e viteve 2013 - 2016) – nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analize kritike, por duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Analiza financiare e viteve 2010 - 2016

<i>Përshkrimi</i>	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	-106 927	347 808	495 684	642 556	635 414	2 840 214	706 169
3 Parcela tokë "Arë " me sipërfaqe 1.296 m2, 4.946 m2 dhe 2.004 m2 të regjistruara në emër të Y. J. P., të fituara në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, për tokën. Në bashkëpronësi, subjekti 20%, apo 1/5 pjesë.							
Tokë "Arë+ ullishte + truall +banesë ", me sipërfaqe prej 1.452 m2, e regjistruar në emër të Y. J. P., e fituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, për tokën. Në bashkëpronësi, subjekti 20%, apo 1/5 pjesë.							
Tokë "Ullishte", me sipërfaqe prej 1.898 m2, e regjistruar në emër të Y. J. P., e fituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 për tokën. Në bashkëpronësi, subjekti 20%, apo 1/5 pjesë.							
Tokë Arë, me sip. 18 dynym e ndodhur në fshatin G***, L***, e fituar në bazë të ligjit Nr.7501 datë 19.7.1991, në emër të kryefamiljarit Rr. D.. Bashkëshorti zotëron 16.6%, apo 1/6 pjesë e pandarë.							
Apartament me sip. totale 115 m, kati i tretë, në Rruga N*** K***, T***. Vlera e apartamentit është 59.878 euro, e cila do të likuidohet me këste. Kësti i parë me vlerë 15.000 euro do të shlyhet ditën e nënshkrimit të kontratës (dt.19.06.2015). Kësti i dytë prej 15.000 euro, do të likuidohet brenda muajit tetor 2015. Kësti tretë në vlerën 15.000 euro, do të likuidohet brenda muajit shkurt 2016, dhe kësti i fundit, në vlerën 14.878 euro, do të likuidohet brenda muajit tetor 2016.						4 129 500	1 014 525
Automjet "F*** F***", fituar me anë të Kontratës së Shitjes nr. 1419 Rep, nr. 1389 Kol., datë 25.6.2012. Vlera është 300.000 lekë.			300 000				
Shtesa/pakësime likuiditete në bankë	-106 927	347 808	195 684	642 556	635 414	-1 289 286	-308 356
<i>Gjendje kursimesh (cash) sipas deklarimeve vjetore</i>	<i>100 000</i>	<i>200 000</i>	<i>600 000</i>	<i>100 000</i>			<i>150 000</i>
<i>Total likuiditete</i>	<i>173 962</i>	<i>521 770</i>	<i>717 454</i>	<i>1 360 011</i>	<i>1 995 425</i>	<i>706 139</i>	<i>397 783</i>
DETYRIME	0	0	0	0	0	2 101 650	0
Detyrim që rrjedh nga kontrata e Huasë në shumën 15.000 Euro, e marrë për pagesën e një kësti për blerje banesë për të cilën është lidhur kontrata për kalim të drejtash. Kjo kontratë është me afat maksimal deri në 15 vjet dhe pa interes.						2 101 650	
Kontratë kalim të drejtash, në shumën 59,878 euro. Shuma e mbetur pa paguar është 22.378 euro.							
Kredi bankare të marrë prane B*** sha në dt. 21.02.2017							
PASURI NETO	-106 927	347 808	495 684	642 556	635 414	738 564	706 169
TË ARDHURA dokumentuar	742 532	1 424 659	1 604 136	1 335 011	1 502 884	1 808 073	1 744 915
Të ardhurat nga paga e subjektit para fillimit të detyrës	390 000						
Të ardhurat nga paga e subjektit nga momenti i fillimit të punës, datë 27.9.2010.	140 762	809 669	657 949	726 610	588 811	1 033 744	1 055 472
Të ardhurat nga paga të bashkëshortit nga muaji Shtator 2010 - Dhjetor 2016	211 770	614 990	614 826	608 401	628 636	673 093	687 790
Të ardhura nga barrëlidjet	0	0	331 361	0	285 437	0	0
Të ardhurat nga interesat bankare të depozitës bankare						101 236	1 654
Dhurata nga familjare dhe miq per hyrjen ne shtepine e re							
SHPENZIME	774 860	744 860	835 145	780 163	1 147 861	1 266 091	1 213 976
Pagesë qiraje banesë në vlerën 20,000 lekë (tetor 2008- dhjetor 2011); janar 2012 -31.12.2016 në vlerën 12.000 lekë në muaj dhe nga 1.1.2017, pagesa e qirasë në shumën e 20.000 lekë në muaj, sipas Kontratës se Qirasë dt. 1.1.2017.	240 000	240 000	120 000	144 000	144 000	144 000	144 000
Interesi i kredisë në B*** sha të marrë në shkurt 2017							
Shpenzime për arsimin e fëmijës J. P.			96 400	64 000	73 000	104 500	31 950
Shpenzime për arsimin e fëmijës I. P.				8 067	24 200	62 133	71 600
Shpenzime për arsimin e fëmijës A. P.						8 800	22 000
Shpenzime arrede dhe mobilimi	125 000	95 000			25 000		
Shpenzime jetike	409 860	409 860	616 337	564 096	879 992	897 104	940 368
Shpenzime udhëtimi	-	-	2 408	-	1 669	49 554	4 058
Analiza dokumentuar	74 599	331 991	273 307	-87 708	-280 391	-196 583	-175 230

13. Konkluzione përfundimtare për kriterin e pasurisë

Komisioni, në përfundim të këtij hetimi administrativ, çmon se në vendimmarrjen e tij përfundimtare, siç konstatohet dhe më lart, duhet të marrë në konsideratë si vijon:

13.1 Lidhur me faktin se a kemi pasaktësi nga subjekti në deklaratimet periodike të sipërcituara dhe cila është pasoja që ka ardhur në drejtim të realizimit të procesit të rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues çmon se për subjektin e rivlerësimit padysim qëndron detyrimi që të deklarojë në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 9049/2003. Për këtë çështje Kolegji i Posaçëm i Apelit ka mbajtur qëndrimin e tij.

13.2 Kolegji i Posaçëm i Apelit, lidhur me këtë, në vendimin nr. 20/2019, në pikat 55 dhe 56 të tij, përcakton se: *“[...] ligji nr. 9049/2003 dhe formulari i deklaratimit të pasurisë përcaktojnë detyrimin e subjektit deklarues të deklarojë në formën e përcaktuar prej tyre dhe jo të zgjedhin ata mënyra të personalizuar për të kryer këtë detyrim ligjor. Forma e deklaratimit nuk është trajtuar prej ligjit si një detyrim alternativ, i cili mbetet në vullnetin e subjektit, por një detyrim i mirëpërcaktuar, i cili duhet respektuar... Në këndvështrim të kuadrit ligjor, subjekti ka detyrë të deklarojë duke prezantuar një fotografi të interesave të tij pasurore e të drejtave mbi pasuritë e paluajtshme e të luajtshme në fund të çdo viti kalendarik, kurse institucionet verifikuese dhe kontrolluese të këtyre deklaratimeve do të duhet më pas të ndjekin konceptet e logjikës dhe matematikës, përfshi rregullat kontabël për të konkluduar nëse këto deklarime prodhojnë ndonjë situatë të shkeljes së ligjit prej subjektit deklarues [...]”*

13.3 Në këtë analizë, Komisioni çmon se referuar vendimmarrjes së deritanishme apo dhe të qëndrimeve të konsoliduara të mbajtura nga Kolegji i Posaçëm i Apelit³², pasaktësitë në deklarime nuk mund të konsiderohen si shkelje të asaj mase të cilat mund të shërbejnë si bazë ligjore për marrjen e masës së shkarkimit.

13.4 Në vendimin nr. 5/2019 përcaktohet se: *“[...] në vijim të analizës dhe interpretimit të dispozitave ligjore si më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, faqja 13 nga 37, vlerëson se sipas ligjit nr. 84/2016, pamjaftueshmëria e deklaratimit për deklarimet e mëparshme periodike të pasurisë, nëse subjekti ka bërë deklaratim të pasaktë, ka fshehur pasurinë apo ka bërë deklaratim të rremë, në vitet përkatëse, nuk është element i mjaftueshëm për t’u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar, që prodhon situatën e deklaratimit të pamjaftueshëm, në kuptim të neneve 33, pikat 5 dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 për shkarkimin e subjektit, por ai mbetet një element, i cili konsiderohet në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit [...]”*

13.5 Në vendimin nr. 19/2019, në pikat 22.14 dhe 22.15 të tij, përcaktohet se: *“[...] trupi gjykues vëren se objekt i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, janë edhe deklaratat e pasurisë të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja që, mbështetur në ligjin nr. 84/2016, nëse subjekti ka bërë deklaratim të pasaktë, ka fshehur pasurinë apo ka bërë deklaratim të rremë, në vitet përkatëse, nuk është element i mjaftueshëm për t’u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar, që prodhon situatën e deklaratimit të pamjaftueshëm, në kuptim të neneve 33, pikat 5 dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për shkarkimin e faqe 11 nga 18 subjektit, por ai mbetet një element, i cili konsiderohet në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit. Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, përcakton që deklarimet e interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji. Këto deklarata, së bashku me provat e tjera, vlerësohen në tërësi me rrethanat e çështjes, për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë. Kontrolli i deklaratës Vetting dhe krahasimi i saj me deklarimet e mëparshme vlerësohet si mjet që shërben gjatë procesit të rivlerësimit për kriterin pasuror, për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklaratimeve të subjektit, në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit apo mjaftueshmërinë e deklaratimeve të tij. Kjo merr vlerë specifike, sidomos në rastin e*

³² Vendimet nr. 11/2018 (JR), datë 22.11.2018; nr. 5/2019 (JR), datë 18.2.2019; nr. 11/2018 (JR), datë 22.11.2018; dhe nr. 5/2019 (JR), datë 18.2.2019, të Kolegjit.

vlerësimin të ligjshmërisë së burimeve të krijimit të një pasurie, pasi këtu paraqitet deklarimi i subjektit në momentin e krijimit të pasurisë, si dhe transaksionet e kryera në vite me këtë pasuri. Kjo analizë është në përputhje edhe me vendimin nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin nënvizohet se organet e reja kushtetuese të procesit të rivlerësimit nuk kanë zhbërë sistemin ekzistues të kontrollit dhe vlerësimit të funksionarëve publikë. Po në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese mban qëndrimin se kompetencat e organeve ekzistuese, siç janë ILDKPKI-ja, DSIK-ja, apo organet e vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk mund të shihen të shkëputura nga kompetencat e organeve të rivlerësimit, pasi procesi i rivlerësimit është një proces kompleks, i cili në bazë të tij ka parimin e bashkëpunimit, të ndërveprimit dhe të kontrollit mes të gjitha organeve të përfshira në të [...]”.

13.6 Në bazë të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pikës 5 të nenit 33, si dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, në analizë të konstatimeve si më sipër, gjatë vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni vlerësoi se pasaktësitë në deklarime dhe konstatimet si më sipër lidhur me balancat negative në shuma të vogla, nuk janë bërë me qëllim fshehjen e pasurisë apo me qëllim deklarimin në mënyrë të pasaktë të të dhënave për shkak të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive. Për këtë shkak, në proporcion me të gjitha rrethanat që kanë lidhje me rivlerësimin e pasurisë, si dhe qëndrimin reflektues që mbajti subjekti i rivlerësimit në lidhje me çdo pasaktësi, ato nuk janë konsideruar si shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit nga detyra.

13.7 Në rastin konkret, nga hetimi dhe nga analiza e provave të administruara, nuk rezultoi që pasaktësitë në deklarimet periodike vjetore të kenë pasur për qëllim fshehjen e ndonjë pasurie apo tregimin jo saktë të të dhënave me qëllim për të justifikuar ligjshmërinë e burimeve dhe të krijimit të pasurive.

13.8 Për këtë arsye, Komisioni çmon se nuk jemi në kushtet e zbatimit të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

13.9 Në analizë të gjetjeve, trupi gjykues çmon gjithashtu se nuk jemi as para zbatimit të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pra, të cenimit të besimit të publikut nga subjekti i rivlerësimit.

13.10 Cenimi i besimit të publikut nga ana e magjistratit është i lidhur ngushtë me faktin se ky i fundit duhet të bëjë një shkelje ligjore gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij. Në rastin konkret është shumë e rëndësishme të arsyetohet se cila do të ishte masa e kësaj shkeljeje dhe se sa një shkelje e caktuar mund të cenojë besimin e publikut për të legjitimuar marrjen e një vendimi në respektim të parimit të proporcionalitetit.

13.11 Komisioni çmon se marrja e një mase disiplinore në përputhje me parimin e proporcionalitetit është në përputhje me qëllimin e ligjit për rivlerësimin. Kolegji ka një jurisprudencë të konsoliduar lidhur me faktin se si duhet të jetë sjellja e një gjyqtari gjatë ushtrimit dhe jashtë ushtrimit të detyrës, në zbatimin e legjislacionit në fuqi.

13.12 Në pikat 41 dhe 22.15 të vendimit nr. 28/2019, përcaktohet se: “[...] trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kjo mënyrë sjelljeje e subjektit të rivlerësimit tregon qasjen e tij në raport me respektimin e ligjit, zbatimin e të cilit është detyra parësore e një gjyqtari, nëpërmjet vendimeve të dhëna, por jo vetëm. Sjellja jashtëgjyqësore e gjyqtarit, për shkak të rëndësisë që ka besimi i publikut tek integriteti dhe autoriteti i pushtetit gjyqësor, është objekt rregullimi i normave të etikës gjyqësore në Shqipëri dhe pjesë e standardeve ndërkombëtare që udhëzojnë shembujt më të mirë të sjelljes dhe integritetit. Më konkretisht, Kodi i Etikës së Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, në rregullin 15 përcakton: ‘Gjyqtari duhet të kryejë të gjitha veprimtaritë jashtëgjyqësore në mënyrë të tillë që ato të mos hedhin dyshime të arsyeshme për paanësinë e tij, të ulin autoritetin e pushtetit gjyqësor ose të ndërhyjnë në kryerjen e detyrave gjyqësore’. Në Komentarin e Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore është trajtuar gjerësisht sjellja e gjyqtarëve në veprimtarinë jashtëgjyqësore, duke e lidhur me elemente të dinjitetit, integritetit, paanësisë dhe reputacionit, ndër të tjera. Për sa i përket

sjelljes së gjyqtarëve, në komentat shtjellohet, ndër të tjera: Paragrafi 108 – Kërkohet respektimi i rreptë i ligjit – Shkelja e ligjit nga një gjyqtar mund të dëmtojë reputacionin e funksionit si gjyqtar, të inkurajojë mosrespektimin e ligjit dhe të cenojë besimin e publikut në integritetin e vetë gjyqësorit [...]. Një gjyqtar është i detyruar të mbështesë ligjin. Ai ose ajo nuk duhet të vendoset në një pozicion konflikti në zbatim të ligjit. Çfarë të tjerët mund të shihet si një shkelje relativisht e vogël, te gjyqtari mund të tërheqë publicitetin dhe dëmtojë imazhin e gjyqtarit dhe të shtrojë pikëpyetje në lidhje me integritetin e tij/saj dhe integritetin e gjyqësorit.

Paragrafi 109 – Sjellja personale e një gjykatësi ndikon në të gjithë sistemin gjyqësor – Besimi në gjyqësor bazohet jo vetëm në kompetencën dhe zellin e anëtarëve të tij, por edhe mbi integritetin dhe drejtësinë e tyre morale. Gjykatësi jo vetëm që duhet të jetë një ‘gjyqtar i mirë’, por edhe një ‘person i mirë’, edhe nëse pikëpamjet për çfarë nënkupton ky koncept mund të ndryshojnë në qarqe të ndryshme të shoqërisë. Nga këndvështrimi i publikut, një gjykatës jo vetëm që është zotuar t’u shërbejë idealeve të drejtësisë dhe të vërtetës mbi të cilat është ndërtuar shteti ligjor dhe themelet e demokracisë, por edhe t’i mishërojë ato. Në përputhje me rrethanat, cilësitë personale, sjellja dhe imazhi që projekton gjyqtari ndikojnë në sistemin gjyqësor në tërësi dhe, rrjedhimisht, edhe vetëbesimin që publiku vendos në të. Kërkesat e publikut ndaj gjyqtarëve janë shumë më të larta sesa kërkohet nga bashkëqytetarët, standarde të sjelljes që janë shumë më të larta se ato të kërkuara të shoqërisë në tërësi. Në fakt, publiku pret një sjellje pothuajse të paqortueshme nga një gjykatës. Është sikur funksioni gjyqësor, që është gjykimi i të tjerëve, ka imponuar një kërkesë që gjyqtari të mbetet përtej gjykimit të arsyeshëm të të tjerëve në çështje që mund të cenojnë në çfarëdolloj mënyre rolin gjyqësor dhe gjykatën [...].

[...] Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues vëren se sjellja e subjektit të rivlerësimit bie ndesh me mënyrën e sjelljes që pritët nga një gjyqtar, i cili edhe jashtë orarit të punës duhet të kujdeset që sjellja e tij të jetë në të mirë të funksionit zyrtar që ushtron, të mos karakterizohet nga fiktiviteti dhe mashtrimi i çdo lloji. Ky përfundim i trupit gjykues gjen mbështetje edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Konkretisht, në çështjen e regjistruar në Kolegj me nr. 31/2018 (JR), trupi gjykues, në vlerësimin e tij [në paragrafët nr. 29 dhe 34] për fiktivitetin lidhur me çmimin e vendosur nga palët në funksion të përfitimit të një kredie, dhe lidhur me përfitimin e një prone [në paragrafin nr. 50] në kushtet kur nuk përmbusheshin kriteret e vendosura nga një akt nënligjor (VKM), ka konstatuar shkaqe në të cilat gjen zbatim neni 61, pika 5, pasi subjekti ka cenuar besimin e publikut te drejtësia për shkak të kontratave fiktive për të përfituar kredi bankare, dhe për shkak të përfitimit të një pasurie në kushtet kur subjekti nuk përmbushte kriteret ligjore për përfitim [...].”

13.13 Në rastin konkret pasaktësitë e konstatuara në DPV, si dhe ekzistenca e një balance të vogël në analizën financiare të subjektit gjatë periudhës së rivlerësimit, përbëjnë arsye të cilat nuk mund të konsiderohen si mënyrë sjelljeje e subjektit në kundërshtim me ligjin, që ka pasur si qëllim përfitimin e një të drejtë në kundërshtim me aktet nënligjore në fuqi.

13.14 E njëjta logjikë vlen dhe duhet të përdoret në konkluzionin se diferencat në vlerë negative të vogël pas analizës financiare të subjektit nuk cenojnë aspak burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktësisht dhe në mënyrë të plotë pasuritë e saj dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Subjekti nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në zotërim ose në përdorim të saj.
- iii. Pasaktësia e konstatuar në deklarin më sipër, si dhe masa e konstatuar në mungesën e burimeve të ligjshme, nuk është në atë shkallë sa të përbëjë shkak për shkarkim, sipas pikës 3 të

nenit 61 dhe nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit, duke cenuar besimin e publikut të drejtësia.

- iv. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Plaku, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në Komision është përcjellë raporti nr. ***, datë 26.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Plaku.

2. DSIK-ja, me shkresën nr. ***, prot., datë 9.2.2021, i ka komunikuar Komisionit se raporti i sipërcituar është deklasifikuar plotësisht në datën 5.2.2021, me vendim nr. ***, të KDZH-së.

3. Në vijim të komunikimeve të mëtejshme me organet ligjzbatuese, përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni nuk kanë rezultuar informacione apo fakte të reja lidhur me këtë kriter. Për rrjedhojë, në vijim të hetimit administrativ dhe rivlerësimit të kryer, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar në dokumentet e administruara në vlerësim të kriterit të kontrollit të figurës, në tërësi, Komisioni arrin në përfundimin se për sa kohë nuk janë gjetur fakte apo rrethana që mund të çonin në konkluzion të ndryshëm nga ai i arritur nga DSIK-ja, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar i përshtatshëm për vijimin e detyrës.

4. Pavarësisht nga raporti i dërguar nga DSIK-ja, Komisioni kreu hetimin administrativ pranë organeve verifikuese dhe kërkoi informacion të përditësuar për subjektin e rivlerësimit.

5. Prokuroria e Përgjithshme ka përcjellë pranë Komisionit informacionin e ardhur nga kjo prokurori dhe prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, nga ku rezultoi se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec informon se ndaj subjektit Irena Plaku është regjistruar një material kallëzues në të cilën ka qenë e kallëzuar edhe subjekti i rivlerësimit.

6. Procedimi penal nr. ***, i vitit 2017, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me vendimin nr. ***, datë 27.5.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë për pushimin e hetimit.

7. Komisioni konstaton se kallëzimi është bërë nga shtetasi S.Gj., i cili ka bërë edhe denoncimin nr.***, datë 22.1.2018, ndaj subjektit të rivlerësimit, me objekt “denoncim falsifikimi”, i datës së kërkesëpadisë.

8. Në përfundim të hetimeve, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka konkluduar për mungesë të dashjes direkte si formë të fajësisë dhe qëllimi i posaçëm për kryerjen e kësaj vepre penale nga ana e të kallëzuarës Irena Plaku dhe ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2017, regjistruar për veprat penale “shpërdorim detyre” dhe “falsifikim i dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 186 të Kodit Penal.

9. Ndaj vendimit të prokurorisë për pushimin e procedimit penal rezulton se nuk është ushtruar ankimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

10. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar informon Komisionin se për subjektin e rivlerësimit, pas verifikimit të veprave penale në këtë prokurori nuk është regjistruar procedim penal në ngarkim, por ndaj subjektit është regjistruar kallëzimi nr. ***, i vitit 2020, për veprën penale të parashikuar nga nenet 259, 309, 249 dhe 25 të Kodit Penal.

11. Pas verifikimeve në lidhje me këtë kallëzim është vendosur mosfillimi i procedimit penal në datën 16.9.2020. Komisioni, referuar përmbajtjes së akteve të procedimit penal të përcjella për

kallëzimin nr. ***, të vitit 2020, konstatoi se kallëzimi në themel është për shkelje dhe veprime në akt ekspertimin e kryer nga ekspertja gjoedete, e thirrur në gjykimin e çështjes civile gjykuar nga subjekti i rivlerësimit.

12. Nisur nga sa më lart, trupi gjykues arrin në konkluzionin se gjatë hetimit administrativ nuk u gjetën elementë që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme për persona të përfshirë në krimin e organizuar, si dhe për sa kohë gjatë hetimi nga agjencitë ligjzbatuese nuk kanë ardhur fakte apo rrethana të reja që do të çonin në një konkluzion të ndryshëm nga DSIK-ja, bazuar në hetimin e kryer sipas nenit DH të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta dhe subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

13. Në zbatim të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Plaku, bazuar në raportin nr. ***prot., datë 22.12.2020, për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nga ku rezultoi se subjekti është vlerësuar pozitivisht për aftësitë profesionale, si vijon:

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Plaku, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjyqtarja Irena Plaku ka njohuri procedurale civile dhe penale. Në përgjithësi, ndjek me rigorozitet hapat procedurale gjatë gjykimin, duke disponuar me urdhra dhe vendime të ndërmjetme në funksion të zgjidhjes në themel të çështjes.

b) Arsyetimi ligjor

Gjyqtarja Irena Plaku ka aftësi për arsyetimin e vendimeve gjyqësore përfundimtare, respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe.

Vendimet e saj janë përfundimtare dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit procedural civil apo penal. Gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së normës ligjore dhe, kur është rasti, për interpretimin e ligjit përdor parime të përgjithshme të së drejtës apo jurisprudencë të gjykatave më të larta. Në tekstet e vendimeve ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Vendimet e saj janë gjithëpërfshirëse në raport me kërkimet dhe prapësimet e palëve. Dispozitivi është rrjedhojë e pjesës arsyetuese. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Gjyqtarja Irena Plaku ka përfunduar gjithsej 785 çështje gjyqësore, nga të cilat 331 çështje penale (114 masa sigurimi, 31 penale të veçanta, 47 kërkesa në fazën e ekzekutimit, 139 penale themeli), si dhe 454 çështje civile (243 çështje civile të përgjithshme dhe 211 kërkesa civile).

Gjyqtarja Irena Plaku, në kohëzgjatjen e gjykimin, ka gjykuar çështje brenda afateve ligjore apo standarde, ndërsa ka treguar kujdes edhe për arsyetimin në kohë të vendimeve.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë për efekt të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Irena Plaku, ndonëse ka pasur ngarkesë të lartë sasiore, e respekton kohën në gjykim si element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor dhe përgjithësisht ka respektuar afatet standarde e ligjore të gjykimit dhe të arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Plaku, ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje përmes vendimeve për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Gjyqtarja i kushton rëndësi edhe caktimit të seancave vijuese në gjykim, ku zbaton parimin e shpejtësisë në gjykim. Orienton drejt debatin dhe hetimin gjyqësor, marrjen e provave të reja, kërkimet dhe prapësimet e palëve deri në dhënien e vendimit përfundimtar. Në të gjitha rastet disponon me vendim të ndërmjetëm e me shkak ligjor për çdo veprim procedural të kryer gjatë hetimit dhe gjykimit.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Gjyqtarja Irena Plaku ka aftësi për të administruar dosjet, Në çdo dosje të vëzhguar gjyqtarja ka nxjerrë vendim për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Irena Plaku. Gjithashtu, sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor (shihni Të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së).

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Plaku, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Plaku.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Irena Plaku komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse në gjykim. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse, si gjatë veprimtarisë përgatitore e asaj gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit Irena Plaku për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Plaku, për shkak të funksionit të gjyqtarës së shkallës së parë, i nënshtrohet detyrimit të programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

14. Komisioni, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur 3 dokumentet ligjore të paraqitura prej saj, 5 dosjet penale të përzgjedhura me short si edhe të dhënat nga burimet arkivore të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Pas verifikimit të raportit Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional.

Denoncimet e paraqitura nga publiku

15. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë paraqitur nga publiku 10 denoncime, të cilët janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse dhe janë administruara disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore për të vlerësuar aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Plaku, si vijon:

15.1 Denoncimet nr. ***prot., datë 17.4.2018, nr. ***prot., datë 26.11.2020, dhe nr. ***prot., datë 30.9.2020, të shtetases E. L.; denoncimet nr***prot., datë 28.6.2019, dhe nr. ***prot., datë 31.7.2019, të shtetases M.M.; denoncimet nr. *** prot., datë 17.8.2020, dhe nr. *** prot., datë 13.6.2019, të shtetases S. H.; denoncimet nr. *** prot., datë 3.12.2019, nr. ***prot., datë 3.12.2019 dhe nr. ***prot., datë 3.12.2019, të shtetasis P. M.; denoncimi nr***prot., datë 22.1.2018, i shtetasis S. D.; denoncimi nr. ***prot., datë 30.10.2019, i shtetasis D. P.; si dhe denoncimi nr. ***prot., datë 28.10.2019, i shtetasis S.Gj. .

Komisioni, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi me objektivitet të gjitha denoncimet e depozituara, nga verifikimet e të cilave kreu hetime shtesë dhe i kërkoi shpjegime subjektit për dy prej tyre.

15.1.1 Në lidhje me denoncimin nr. *** prot., datë 19.10.2020, të shtetasis H. B., subjekti i rivlerësimit pretendoi se deri në datën 19.10.2020, datë e depozitimit të ankimit në Komision, nuk është njohur me vendimin e arsyetuar, vendim i cili është shpallur prej saj në datën 10.6.2021. Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të japë shpjegime mbi pretendimet e denoncuesit, duke vënë në dispozicion edhe dokumentacion provues mbi dorëzimin në sekretarinë gjyqësore të vendimit nr. ***, datë 10.6.2020. Në parashtrimet saj, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se çështja civile është zhvilluar në praninë e dy sekretareve gjyqësore. Gjatë procesit të inventarizimit të dosjes u konstatua se njëra nga sekretaret, e cila ishte larguar nga puna, nuk kishte firmosur procesverbalet e seancave gjyqësore. Pas disa përpjekjeve për të kontaktuar me sekretaren e larguar nuk u arrit të kontaktohet dhe vendimi u dorëzua në sekretari me shënimin në pritje të sekretarës së larguar. Subjekti, më tej vijon duke shpjeguar edhe arsyen e ngarkesës së madhe të çështjeve gjyqësore, përfshirë edhe urdhra mbrojtjeje, të cilat kanë një afat të veçantë të gjykimit dhe shqyrtimit gjyqësor. Subjekti ka depozituar, së bashku me shpjegimet, edhe fletë nga regjistri i veçantë i vendimeve, nga ku rezulton se vendimi nr. ***, datë 10.6.2020, është dorëzuar në sekretari në datën 21.11.2020.

15.1.2 Në procesin e vendimmarrjes lidhur me këtë çështje, Komisioni vlerësoi se kohëzgjatja e depozitimit të vendimit në sekretari nuk ka cenuar të drejtat e palëve në proces, pasi rezultoi se vendimi iu është komunikuar palëve në datën 9.12.2020, dhe pala paditëse ka paraqitur ankim më 22.12.2020. Po kështu, referuar edhe vendimit³³ të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku përcaktohet se: *"... pavarësisht afateve të parashikuara në ligjet tona procedurale, qofshin ato civile dhe penale, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë dhe janë të ndërgjegjshme se jo gjithmonë këto afate mund të zbatohen me rigorozitet nga ana e gjyqtarëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre dhe jo gjithmonë mosrespektimi i tyre është shkak ligjor për marrjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve nga ana e KLD-së. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se pamundësia për të respektuar maksimalisht këto dispozita mund të justifikohet nga ekzistenca e*

³³ Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë, i vitit 2012.

shkaqeve objektive, të cilat nuk varen nga gjyqtarët dhe që mund ti pengojnë në respektimin rigoroz të këtyre normave, siç mund të jenë ngarkesa e madhe në punë; kompleksiteti i çështjeve në ngarkim; sjellja e palëve gjatë procesit; pamundësia objektive e gjykatave për zhvillimin e procesit gjyqësor, shkaqe të justifikuara shëndetësore apo familjare, të cilat mund të kenë ndikim direkt tek gjyqtari dhe nuk e lejojnë atë të ushtrojë detyrën e tij, etj.”.

15.1.3 Ndërsa, lidhur me ngarkesën e subjektit të rivlerësimit në periudhën në fjalë, nga verifikimi i dokumenteve të paraqitura³⁴ prej saj vërtetohet se subjekti ka pasur ngarkesa të çështjeve të urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe caktimin e gatshëm në gjykime gjatë kësaj periudhe. Në periudhën qershor – nëntor 2020, sipas të dhënave nga sistemi elektronik, kopje e të cilit është vënë në dispozicion të Komisionit nga subjekti, rezulton se ka dhënë 247 vendime përfundimtare.

15.1.4 Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e dhëna me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore, çmon se vendimi nr. ***, datë 21.11.2020, është dorëzuar jashtë afatit 10-ditor të parashikuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile. Në procesin e vendimmarrjes lidhur me këtë çështje, Komisioni vlerësoi se referuar të gjitha sa janë parashtruar dhe vërtetuar nga subjekti në ushtrim të barrës së provës, kohëzgjatja e gjykimit të çështjes nuk ka ardhur për shkaqe subjektive dhe të pajustificuara.

15.2 Denoncimi nr. *, datë 21.3.2019, i përfaqësuesit të shtetases S. Sh., av. A. K.,** ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit ka dhënë një vendim antikushtetues, duke i mohuar palës së paditur S. Sh. të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor dhe të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme. Pretendohet gjithashtu se subjekti i rivlerësimit, me vendimmarrjen e saj, ka shkelur parimin e së drejtës, ka dhunuar barrën e provës, ka shkelur parimin e ligjshmërisë së provave, nuk ka zhvilluar një hetim të plotë gjyqësor, ka dhunuar të drejtën e mbrojtjes dhe ka dështuar të japë një cilësim të drejtë fakteve dhe rrethanave në kuptim të neneve 10-24 të Kodit të Procedurës Civile. Subjektit, gjatë procesit të rivlerësimit, por edhe në përfundim të hetimit administrativ, iu kërkuar të japë shpjegime lidhur me shqyrtimin gjyqësor të çështjes civile, me palë ndërgjyqëse shtetaset N. Sh. dhe S. Sh., me objekt “lëshim urdhër mbrojtje”. Subjekti, në parashtrime deklaroi se çështja civile me objekt “lëshimin e menjëhershëm të urdhrit të mbrojtjes” është regjistruar në datën 21.12.2018, datë në të cilën është regjistruar gjithashtu edhe kërkesëpadia e palës së paditur S. Sh., si paditëse me palë të paditur N. Sh., po me objekt “lëshimi i urdhrit të mbrojtjes”, e cila është shortuar dhe ka filluar shqyrtimi nga një tjetër subjekt rivlerësimi. Gjyqtarja Irena Plaku, me urdhrin e datës 27.12.2018, ka urdhëruar kalimin e çështjes civile në seancë gjyqësore. Rezulton se çështja gjyqësore është bashkuar në datën 9.1.2019 dhe është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit Pas bashkimit të çështjes, në përfundim të gjykimit, subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendimin nr. ***, datë 8.2.2019. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e dhëna me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore, çmon se vendimi është dhënë jashtë afatit 15-ditor të parashikuar nga pika 1 e nenit 16³⁵ të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

15.2.1 Në rastin konkret, nga shqyrtimi i akteve në dosje, konstatohet se në këtë kohëzgjatje kanë ndikuar edhe zhvillimi i seancave gjyqësore paralele me të njëjtat palë dhe të njëjtin objekt nga subjekti tjetër i rivlerësimit.

³⁴ Shkresë nr***prot., datë 6.4.2021; kopje të fletës së regjistrimit të numëratorit të numëratorit të vendimeve civile; kopje të fletës së regjistrimit të ankimeve; kopje të dëftesave të komunikimeve të vendimeve dhe ankimeve, ku provohet data e marrjes dijeni për vendimin dhe ankimin e kundërankimin, si dhe kopje të ankimit dhe kundërankimit të paraqitur nga palët; kopje të fletës së dorëzimeve të mbajtura nga sekretaria gjyqësore; kopje të kërkesave për leje, si dhe të urdhrave të këshillimit të gjykatës për caktimin e listave të gatishmërive; dokumenti “ngarkesa e gjyqtareve” nga data 1.6.2020 deri më 30.11.2020, e gjeneruar nga sistemi elektronik i gjykatës, ku pasqyrohen vendimet përfundimtare të dhënë gjatë kësaj periudhe; lista e seancave të zhvilluara për periudhën 15.6.2020 – 15.11.2020, të printuara nga sistemi i gjykatës.

³⁵ Gjykata vendos për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës.

15.2.2 Në konkluzion të vlerësimit të kësaj çështjeje nga Komisioni, në vlerësim të të gjitha rrethanave dhe provave që subjekti paraqiti, nuk është vërtetuar që tejkalimi i afateve të gjykimit të ketë ndodhur për shkaqe të pajustificuara objektivisht dhe ligjërisht nga subjekti apo të jetë kryer me qëllim cënim e të drejtave të palëve në proces dhe, si i tillë, nuk mund të përbëjë shkak për penalizim të subjektit të rivlerësimit, ashtu sikurse parashikohet në qëndrimin e mbajtur edhe nga KPA-ja³⁶.

15.2.3 Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimet dhe pasi mori në shqyrtim ankesat e mësipërme, konstaton se pretendohen fakte që kanë lidhje me korrektësinë e vendimeve dhe themelin e çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, fjalës e fundit, faqja 60 nga 64 e Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

Vlerësimi i Komisionit

16. Bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni analizon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerëson.

16.1 Pavarësisht sa më sipër, në raport me të gjitha çështjet e analizuar, rezultoi se subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit dhe në kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, si dhe zotëron njohuritë ligjore dhe të arsytimit ligjor, referuar nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

16.2 Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, sipas kriterëve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues çmon se sa i takon dy çështjeve për të cilat u evidentuan tejkalime të afateve të gjykimit, analizuar në mënyrë specifike si më sipër, Komisioni iu referua vendimit nr. 69, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit: *“Arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuarit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuarin kjo tejkalgjatje e afateve të gjykimit. Gjykata³⁷ ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme”,* se zgjatja e afateve në çdo rast nuk ka qenë për faj apo neglizhencë të subjektit të rivlerësimit, por ka ndodhur për shkaqe objektive e të përligjura.

³⁶ Shihni vendimin nr. 21, datë 13.9.2019, të KPA-së, për subjektin Gentian Medja – aftësia për të përballuar ngarkesën e punës matet duke u bazuar në treguesit për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i kushtohet çdo çështjeje, rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore dhe kohën mesatare për marrjen e vendimit përfundimtar gjyqësor ose të prokurorisë për një çështje; vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese, par. 52, 53 dhe 54, vlerësim negativ, i cili është vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara që tregojnë mungesë të aftësive profesionale. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale, duke iu referuar opinionit CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias.

³⁷ Shihni vendimet nr. 14, datë 15.4.2010 dhe nr. 9, datë 14.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese.

16.3 Në asnjë rast, subjekti i rivlerësimit nuk është bërë shkak me veprimet apo mosveprimet e tij për tejkalimet e afateve të gjykimit dhe nuk u vërtetua që këto tejkalime të kenë qenë të qëllimshme, por kanë ardhur për shkaqe të pavarura prej tij, si dhe për shkak të kompleksitetit të çështjeve, rrethanë e cila vlerësohet proporcionalisht në raport edhe me treguesit e tjerë brenda kriterit të aftësive organizative, sikurse ngarkesa në punë.

16.4 Subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016.

16.5 Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016. Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

16.6 Në këto kushte, trupi gjykues, pasi ka çmuar faktet dhe rrethanat që lidhen me aktet e shqyrtuara më herët nga KLGJ-ja, si dhe me denoncimet nga publiku, nga një vlerësim i përgjithshëm i kriterit profesional, mbërrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Plaku, ka arritur një nivel kualifikues me vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse.

16.7 Në përfundim të procesit të rivlerësimit, në analizë të të gjitha denoncimeve, Komisioni konstatoi se nuk ka *indicie* për të provuar pretendimet e denoncuara, për gjetje që do të ndikonin në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Nga vlerësimi tërësor i aftësive profesionale, u konstatua se mangësitë e evidentuara nuk janë të tilla që të cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit apo që të kenë cenuar të drejtat e palëve në proces, në kuptim të pikave 3 dhe 5, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, dhe, si rrjedhim, Komisioni çmoi që subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, duke respektuar të drejtat e palëve dhe ka qenë efiçente dhe efektive në masë të pranueshme dhe për këtë arsye është vlerësuar “i aftë” profesionalisht.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Plaku, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. Ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.
- b. Ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c. Ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Plaku, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelistit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Vendimi u shpall në Tiranë, në datën 23.6.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta Tafa (Bungo)
Kryesuese

Lulzim Hamitaj
Anëtar

Alma Faskaj
Relatore

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta